





DIANA SEITAJ  
**KRENARIA E NJË GRUAJE**  
NOVELA

---

BOTIMET TOENA



DIANA SEITAJ

KRENARIA E NJË GRUAJE

novela

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Recesente dhe redaktore: Diana Çuli

Korrektore letrare: Petrina Ago

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-92-3

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. “M. Gjollësia”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

# ISHULLI I PALMAVE



## *Një grua si Sofia*

Ndoqi heshtur rrugën e asfaltuar mes një gjelbërimit marramendës dhe, tërësisht e dashuruar me atë mjedis magjepsës, falënderoi Zotin për mundësinë e asaj dite. Më pas, ngjiti ngadalë disa shkallë të gurta në formë gjysmërrethi dhe, butonin e ziles e shtypi lehtë, vetëm dy herë, me ndjesinë e vetvetishme se tingulli i saj, ndoshta do të gërvishte atë mbështjellje aq harmonike dhe të dëshiruar, ndërsa sytë i mbetën për një çast mbi kutinë metalike të postës dhe pothuajse harroi përse kishte trokitur, kur derën ia hapi një burrë i pashëm dhe pak i trashë, kjo ishte përshtypja e menjëhershme dhe fillestare, para asaj figure të panjohur. Sofia nxitoi t'i thoshte se ndodhej atje sipas kontratës që kishte firmosur para disa ditësh, e habitur pak me veten dhe mënyrën jo të zakonshme të të shprehurit.

- Oh, përshëndetje, unë po ju prisja..., jam Billi, po hyni..., hyni ju lutem!

- Është kënaqësia ime të punoj për, - filloi ajo, ndërsa çuditërisht po mendohej të orientohej dhe të zgjidhte fjalët.

- Prindërit e mi, ata banojnë këtu, por unë i vizitoj shpesh, jam shumë i kujdesshëm për ta, duhet apo jo?

- Bëni shumë mirë, - dhe ajo kërkoi sërish të zgjidhte fjalët, - mendoj se nuk është vetëm detyrë, por një preokupim i natyrshëm, njerëzor dhe i domosdoshëm, në opinionin tim!

- Sa bukur flisni dhe bëni shumë pak gabime. Në mos gaboj, ju vini nga... më ndihmoni ta them ju lutem, ndonjëherë jam keq me kujtesën!

- Shqipëria, unë jam shqiptare!

- Ah, po, më falni, por uluni, uluni ju lutem! - dhe i tregoi me dorë tavolinën, diku shumë pranë saj. Ajo mendoi se ai po e priste me një përkujdesje të veçantë, apo ashtu po i dukej asaj?

Sofia u ul menjëherë në ndenjësën më të afërt, pranë një tavoline të rrumbullakët, në një mjedis të mobiluar me shije shumë të hollë, komod dhe tepër funksional në pamje të parë. Billi i vuri përpara limonadë dhe disa ëmbëlsira të zgjedhura. Ajo mori një amaretë dhe i tha se shtëpia e tyre i dukej vërtet e mrekullueshme, ndërsa ai e priti këtë me një kënaqësi të hapur.

- Jeni mësuese me sa di, por në pamundësi të praktikoni profesionin detyroheni t'u përshtateni rrethanave, kështu është? Më korrigjoni nëse gaboj!

- Po, është pikërisht ashtu! E kam të pamundur ta bëj menjëherë, por shpresoj të mbroj diplomën sa më shpejt e, më pas, do të më duhet të gjej edhe vendin e punës.

- Jam i sigurt se do t'ia arrini... - dhe ai kërkoi përsëri ndihmën e saj. - Sofia, në mos gaboj!

- Po, po, emri im është Sofia!

- Faleminderit Sofia! Dhe tani, besoj se doni të dini, çfarë duhet të bëni këtu, apo jo? Jam gati të shpjgohem.

- Po, nëse mundeni, z. Dagllas!

- Më thërrisni Bill, është më mirë kështu, Sofia! Po merrni edhe një çokollatë, ju s'po hani fare ëmbëlsira dhe nuk mendoj ta keni problem peshën, dukeni mirë me shëndet. Unë e shkel, e kam këtë dobësi, më pëlqen të ha.

Ai qeshi sërish shpenguar dhe Sofia provoi ta ndiqte gjithashtu, me një fytyrë të hijshme, por disi e befasuar edhe me veten nga ai emocion jo i zakonshëm, para atij burri të panjohur.

- Ju do të jeni shoqëruesja e prindërve të mi, në shtëpi dhe jashtë saj... - ai filloi të fliste shpejt dhe asaj i duhej të përqendrohej, për të kapur çdo fjalë. - Unë i vizitoj shpesh, por nuk mundem të bëj gjithçka duhet për ta. Janë të moshuar, babait i nevojitet një trajtim i veçantë, ka pasur komplikacione edhe me zemrën. Mamaja gjithashtu nuk është e re si dikur, ndërsa mua më duhet koha e mjaftueshme për t'u marrë me jetën time. Jemi të pasur dhe mund të bëjmë më të mirën për veten, fatmirësisht kështu, Sofia... Më pëlqen ky emër, më duket se është emri i një artisteje të madhe...

- Italiane, Sofia Loren!

- Ah, po, është një yll kinemaje, aktore me përmasa botërore, një grua vërtet e mrekullueshme, duhet të them! Po nga aktorët amerikanë, kë do të zgjidhnit, a keni ndonjë preferencë, Sofia?

Ai e artikuloi emrin e saj tepër ngrohtë, apo ashtu iu duk asaj? U mundua sërish të ndiqte bisedën.

- Julia Roberts, Tom Hanks, Mel Gibson... janë shumë! Midis tyre do të veçoja ndoshta Kathrin Zeta Johnes në filmin, - ai e ndihmoi në përcaktimin e titullit.

- Personalisht, preferoj Robert De Niro, por sigurisht, e vlerësoj edhe zgjedhjen tuaj...

- Mos jeni me origjinë italiane? - e ndërpreu padashur, Sofia, disi më e lirshme në komunikim.

- Vetëm babai, ndërsa mamaja është amerikane. E shoh, keni intuitë dhe shije të hollë. Më vjen keq që nuk e njoh fare vendin tuaj! Nëse më lejoni, a mund të di përse u larguat?

Nuk ishte i pari që kërkonte arsyen e shpërnguljes dhe, Sofia, e familjarizuar tashmë me atë detyrim, bëri shpjegimin e zakonshëm. I tregoi se vendi i saj ishte viktimë e një krize të thellë politike, shoqëruar kjo edhe me probleme të ndjeshme ekonomike, ishte një gjendje e njohur kjo në vendet ish-komuniste të Lindjes, një tornado tranzicioni dhe një zhvendosje e pashmangshme, nëpër rrethana të acaruara, që stimulonin konflikte të rënda sociale dhe morale, një realitet me tinguj rebelë, dramatikë dhe shpesh edhe tragjikë për banorët. Ajo mundi të shkëputej, me të drejtën e natyrshme për të kërkuar një zgjidhje, apo një mundësi të re, edhe pse kjo mund të ishte e përkohshme, sepse njeriu s'mund t'i parashikonte asnjëherë ato që nuk vareshin prej tij.

- Jeni e martuar, Sofia? - e pyeti befas ai dhe u zgjat të merrte një amaretë, ndërsa Sofia iu përgjigj sikur të kishte pritur pikërisht për atë pyetje. Më mirë të fliste, sepse e kishte më të lehtë qëndrimin.

- Jo, jo, ndihem e papërgatitur për një preokupim të tillë, për mua familja është përgjegjësi, jam plotësisht e sigurt se nuk do ta bëja si duhet.

- Nuk duket ashtu, por e lëmë këtë... Banon vetëm këtu?

- Me një shoqe, kam edhe disa lidhje të vjetra familjare dhe po mundohem të përshtatem, por duhet ta dini, nuk është e lehtë!

- Të uroj fat, Sofia, dhe jam i bindur se do ta bësh mirë punën. Prindërit e mi nuk janë këtu, por do të kthehen shpejt nga shëtitja e pasdites. Gruaja që ka shërbyer deri tani, është një ruse e këndshme e shumë e zellshme, por i duhet të largohet. Shpresoj dhe dëshiroj ta pëlqeni njëri-tjetrin, mundohu të bësh atë që kërkojnë, edhe kur kjo mund të të duket e parëndësishme ndoshta, më kupton Sofia? Mamanë e le dhatojnë veçanërisht komplimentet, e ndihmojnë të ndihet e re, kjo mendoj do të jetë plus edhe për ty. Dëshiron të qëndrosh këtu sonte?

- Jo, jo, - nxitoi të përgjigjej ajo, - erdha sa të prezantohem, por mund të filloj kur të dëshironi, jam e lirë në fakt! Punoj me orë të reduktuara dhe mund të shkëputem menjëherë. Është kënaqësia ime të bëj diçka për ju, nëse do të mundem...

- Jam i sigurt për këtë... Gjithashtu ndihem mirë që u njohëm... - ai nuk shkoi deri në fund, por pas një pauze gjurmëlënëse, plotësoi fjalinë me shkathësi. - Dëshiroj të hamë darkë bashkë, a mundesh Sofia?

- Faleminderit, pse jo! - dhe përsëri u habit me veten, ndaj u ngrit menjëherë dhe e bëri padashur, sikur të kërkonte një qëndrim më të rehatshëm, por Billi foli i pari, pa e lënë të pendohej.

- Mund të të shërbej, Sofia? - dhe i sjellshëm u ngrit ta ndihmonte, duke i ofruar çantën dhe xhaketën.

- Më falni zoti..., më falni Bill, a mund të presim në verandë, ju lutem, keni një kopsht të bukur, më duket se u dashurova me të, që në momentin e parë.

- Ndërsa unë nuk ndihesha shumë i sigurt për ta kërkuar! Mirë, atëherë, dalim Sofia! - dhe ai u ngrit i pari.

E lejoi të ecte pak para tij dhe ndoqi hapin e saj. I pëlqeu aroma e një parfumi të zgjedhur, shumë pranë saj, dhe kjo e ngacmoi. Sofia, gjithashtu, po përjetonte mbresat e një çasti të veçantë. Kishte hyrë në jetën e atij vendi para disa muajsh, me një vizë të rregullt dhe të drejtë punësimi për një periudhë të përcaktuar disavjeçare. Me Klarën, shoqen me të cilën banonte prej fillimit, ishin njohur vetëm disa ditë para udhëtimit. Ishte një lidhje që e pranuan në varësi të momentit dhe interesave, por shumë shpejt arritën të besonin dhe ta mbështesnin njëra-tjetrën, pavarësisht kohës së njohjes.

Klara gjithashtu do të kërkonte dhe do të gjente te shoqja çdo gjë që i mungonte, fatmirësisht mund të prehej e qetë pranë saj. Përbënin një unitet ndjenjash dhe një kontakt të fortë miqësor. Në një pozicion, pak a shumë si të Sofisë, Klara ia doli të punësohej si sekretare, në një kompani të fuqishme sigurimesh shëndetësore dhe kjo ua bëri më të lehtë banimin në një apartament të vogël, vetëm me një dhomë gjumi, pagesa mujore e të cilit dukej e arsyeshme.

Ndërsa lëvizte shpënguar pranë Billit, kujtimet nuk harruan t'i kundërvihen, duke gërvishur padashur realitetin. I ndodhte kjo sa herë përballej me një opinion, figurë, apo objekt tërheqës, të cilin pa kuptuar pse, mendohej ta vendoste menjëherë pranë një detaji të njohur dhe të largët, ose ta fuste brenda një kontakti të vjetër, apo ta lidhte diku me një trajtë, që merrte frymë vetëm në kujtesën e saj.

I mendoi këto kalimthi, ndërsa momenti provokoi sërish atë gjendje pasigurie, duke rizgjuar, jo rastësisht ndoshta, portretin e harruar të një shoku të dikurshëm. Ishte simpatik

dhe shumë i sjellshëm, kishin ecur gjatë të dy dhe mbi atë rrugë Sofia kishte pritur, por, kishte pritur vërtet, apo ashtu po i dukej? E shkëputi befas zëri çuditërisht i ngrohtë, i punëdhënësit të ri dhe njëkohësisht edhe pronarit të asaj shtëpie marramendëse.

- Këtëj Sofia, duhet të shohësh një gjë shumë interesante, - e tërhoqi lehtë ai, - është një trill i imi nga fëmijëria, por nuk dua ta humbas. Kam kujtime shumë të bukura në këtë shtëpi, por do të kemi kohë të flasim dhe të njohim njëri-tjetrin, apo jo?

- Sigurisht, do ta vlerësoja shumë z. Dagllas! - u ngatërrua sërish ajo.

Provoi më pas, të hynte nëpër ngjyrat e rrugës që i tregoi ai dhe guxoi sërish t'i pohonte vetes se, ai shoqërues tepër simpatik, i rastësishëm ose jo, ishte pa dyshim një burrë i mirë.

\* \* \*

Eli nxitonte të arrinte dritën e semaforit, por nuk mundi. E dinte mirë se edhe një vonesë, sado e vogël në trafik, do t'i kushtonte. Ndodhte të vonohej mëngjeseve, mbikëqyrësja do të përsëriste para saj refrenin e njohur dhe shpesh kjo do të gjymtonte edhe pagën mujore, sepse në grafikun e përditshëm, koha e prodhimit matej me përpikërinë më të madhe, e minimizuar rregullisht, deri në sekondat e fundit. Punonte prej dy vjetësh në një fabrikë elektronike, diku në periferi të qytetit. Kishte qenë aq i vështirë ai hap e,

nëpër gjurmët e asaj rruge, ajo s'kishte për ta harruar kurrë kontaktin fillestar me frikën se ndoshta nuk do të mundej, por qëllimi e ndihmoi atëherë të sfidonte atë për të cilën edhe më pas do ta pyeste veten, se si kishte mundur!?

Kishte qenë me siguri lufta për të mbijetuar, detyrimi moral i një nëne, por edhe shpresa për t'u rikthyer ndoshta. Punonin pesë ditë në javë, u paguheshin të gjitha pushimet vjetore, përfshirë këtu edhe sigurimin shëndetësor familjar. Me pagën e saj mbulonin të gjitha detyrimet mujore, kurse të ardhurat e Maksit, modeste edhe ato, mund t'i depozitonin në llogarinë e përbashkët bankare. Maksi punonte si mirëmbajtës në një hotel të madh, diku pranë vendit ku banonin. Eli, gjithashtu, mund të bënte një punë shumë më të lehtë atje, por për më tepër të ardhura mujore, të cilat u nevojiteshin aq ndjeshëm, vazhdonte të sakrifikonte, duke ndjekur intensitetin e një dite të gjatë dhe të lodhshme pune. Kujtoi se do t'i duhej të çonte në pastrim disa veshje dimërore, para se t'i sistemonte në pritje të sezonit tjetër. Atje shërbente një kineze antipatike, me një fytyrë të varur, që në çdo takim i krijonte përshtypjen se nuk qeshte kurrë. Në çdo rast pranë saj, Eli provonte të komunikonte e pavarur nga pamja dhe toni i tjetrës, por dilte përherë me ndjesinë se do t'i duhej të paguante për një punë jo shumë cilësore. Mendoi se do të bënte mirë të zgjidhte një tjetër shërbim, ku të reflektonte më tepër mirënjohja për klientin dhe se...

Ndjeu ta ngacmonte sërish zhurma e motorit të makinës, pamjet aq të njohura dhe monotone në dy anët e kalimit kryesor, atje ku vende-vende, njerëz të lodhur vazhdonin

të prisnin për autobusin e radhës, mure të vizatuar që kërcënonin me atë hije të jashtëzakonshme hijesh dhe ngjyrash, kërkoi të shkëputej dhe, si përherë, ndaloi te Fiona, vajza e vetme e tyre. Gjendja e së bijës, përcaktonte zakonisht humorin e familjes. E donin njëri-tjetrin dhe kjo e bënte më të lehtë barrierën.

Ata të dy flisnin një anglishte jo të plotë, ndaj Fiona qeshte shpesh me gabimet e rastit, por ata i luteshin t'i korrigjonte, ndërsa mundoheshin fort të përvetësonin me sa mundeshin gjuhën e dytë. Në fabrikë Eli punonte me amerikanë, polakë dhe meksikanë, kurse në hotelin ku punonte Maksi, kryesisht meksikanë dhe disa kinezë në shërbimet e kuzhinës dhe restorantit. Ai shkonte mirë me të gjithë e disa prej tyre i njëjtte edhe Eli, por këto marrëdhënie asnjëherë nuk morën trajtën e një lidhjeje miqësore, këtu bënin përjashtim vetëm shoqet e Fionës dhe disa kontakte të hershme të familjes.

Eli mendoi se po vonohej tepër atë mëngjes, të tjera minuta mes një trafiku të ngarkuar, dhe ndoshta përsëri nuk do ta kapte kohën. Kujtoi se kishte disa ditë pa i parë Klarën dhe Sofinë. I donte ato vajza. Ishin më të reja se ajo, por e kërkonin, ndërsa ajo vetë merrte në shoqërinë e tyre atë që i mungonte, zërin e moshës dhe të kohës, por edhe energjinë për të ecur mbi përvoja të panjohura. Ato ndikonin pozitivisht te Fiona, ndërsa kjo e shprehte hapur simpatinë ndaj tyre, kur iu përgjigjeshin me seriozitet gjithë pyetjeve të saj, të vetëdijshme për atë që duhej t'i mësonin, ndërkohë që ata si prindër, e vlerësonin maksimalisht këtë

kontakt të vyer. Maksi i ndihmonte kur i luteshin për diçka, ndërsa Eli s'mund të priste gjatë pa i thirrur. E dëshironte harmoninë e tyre, e ndihmonin të mos harronte kush ishte dhe nga vinte, duke lehtësuar disi edhe ngarkesën e jetës në vendin mikpritës.

Arriti vonë dhe kontrollorja e cilësisë përsëriti refrenin e njohur, ndërsa Eli pa folur, u tërhoq me po atë qëndrim të përulur. Pranë makinës e prisnin kutitë e çelësave elektrikë, mijëra pjesë do të kalonin nëpër duart e saj dhe, në fund, ajo do të largohej e lodhur, pavarësisht prirjes për të bërë rezistencën e domosdoshme. Si zakonisht, mbikëqyrësja, një polake trupmadhe dhe e rreptë, atë ditë do të ndalonte shpesh te makina eELIT dhe kësaj do t'i duhej të aprovonte dhe të premtonte për një angazhim më produktiv. Ndiqte ritmin e punës me nerva të tendosura, duke i thënë vetes se duhej ta bënte, se për atë ndodhej atje, pikërisht për atë dhe se ajo do të mbaronte shpejt, pas disa orësh, ndërsa Eli do të kthehej mbi po atë rrugë, me po atë qëllim, duke pritur një tjetër mëngjes.

E shkëputi sinjali elektrik i pushimit të drekës dhe mendoi se kishte kaluar gjysma e ditës. Ishin vetëm dy shqiptare mes atij grupi të madh punëtorësh, tek i cili vlerësonte një polake simpatike, të sjellshme dhe shumë korrekte. E quanin Tesi. Gjente diçka nga vetja në portretin e saj dhe tjetra përgjigjej po ashtu. Tesi e kishte ftuar disa herë të dilnin për darkë edhe me bashkëshortët e tyre, por Eli s'ishte përgjigjur. Mendoi se do të bënte mirë ta pranonte ftesën, do t'ia kërkonte Maksit, sepse kishte

respekt për atë grua dhe, së fundi, Tesi ishte një emër që përfaqësonte një tjetër kulturë, dhe kjo mbetej interesante për t'u ndjekur. Dilnin ndonjëherë me Fionën, zakonisht në disa restorante jo të kushtueshëm, por rrallë të dy. Maksi preferonte mbrëmjet e qeta para ekranit televiziv, ose në shoqërinë e disa të njohurve të vjetër. E karakterizonte një ndjesi vetizolimi, kur bëhej fjalë për një ndryshim, apo përshtatje me rrethanat e reja edhe pse Eli e kërkonte këtë. Intuita e ndihmonte të mos gabonte kur zgjidhte dhe kjo e bënte tërheqëse në sytë e Fionës. Vajza i fliste për momente të rëndësishme në marrëdhëniet shoqërore dhe besonte te këshillat e së ëmës. Ata njihnin çdo lëvizje të saj, çdo reflektim, apo pasqyrim të një realiteti jo shumë të vlerësuar prej tyre. Ishte e kuptueshme kjo. Vinin nga një horizont i ndryshëm kulturor, i cili pavarësisht nga prirja dhe besimi, kishte krijuar brenda dhe jashtë tyre rrezatimin e vet, pas të cilit kishin mbetur ndezur vetëm shkëndijat e zgjedhura prej tyre, kjo tërësi ngjyrash dhe ndjesish i kishte vënë emrin edhe moralit që bartnin, perceptimit shoqëror, dhe atij të dashurisë. Nuk donin dhe nuk kishin arsye ta mohonin krejtësisht atë, sepse do të thoshte të shkelnin padashur mbi një pjesë të jetës dhe shpirtit të tyre. Ata besonin atje dhe dëshironin ta trashëgonin edhe te Fiona, mbetej një mision i rëndësishëm prindëror, brenda përditshmërisë dhe të panjohurës. Eli në çdo rast do të arrinte ta gjente fjalën dhe argumentin e duhur, ndërsa Fiona do të ndihej përherë e sigurt dhe e mbrojtur pranë arsyetimit, dhe përkujdesjes të së ëmës, kur në sfondin e një konflikti kalimtar, asaj nuk do

t'i mungonte asnjëherë mirëkuptimi reciprok, mbështetja dhe ngrohtësia e familjes. Aftësitë dhe botëkuptimi iELIT, me një intuitë të bukur nëne, përcaktonin një lëvizje të suksesshme dhe në fund fatmirësisht, Fiona ishte një vajzë që dinte ç'bënte.

- Eli, dukesh pak e lodhur sot, është Maks, apo vajza? - u afrua Tesi e freskët dhe energjike si përherë. Shpesh ato e konsumonin bashkë pushimin e drekës.

- Jam vetëm unë. Në të vërtetë ndihem pak nervoze sot, kështu ndodh sa herë më duhet një pushim i gjatë.

- Më vjen keq, e dashur, por edhe këtë muaj nuk kemi asnjë festë apo... çfarë ka ndryshuar sot, më lër të shoh! Ah, po, më duket ngjyra e flokëve!

- Ti e di, më pëlqen ndryshimi, - dhe ato shkuan më tej për veshjen e fundit të atij sezoni, për një stil të ri flokësh, për një dyqan këpucësh me shumë interes dhe, tingulli i njohur lajmëroi vazhdimin e punës. Eli u zhyt në lëvizjen e makinerisë, ndërkohë që mbetej e pashmangshme kjo, ndërsa mendimi do t'i shkonte përsëri te Fiona. Kishte vënë re se vajza qëndronte shumë kohë para kompjuterit, por i tha vetes se edhe kjo lidhej pa dyshim me studimin. S'kishte mundësi t'i kontrollonte lëvizjet e saj në internet dhe as nuk donte të bënte rolin e përgjuesit, por njihte mirë rrezikun që vinte prej tij, apo misterin që fshihej pas një pasqyrimi shpeshherë fals dhe të gënjeshtërt, pas një figure joreale, apo edhe një sentence makabër, e cila krijohet dhe buronte kushedi prej ku! Sipas saj, pavarësisht përparësive dhe emocioneve të komunikimit, ai ekran ishte një botë

më vete, me të vërtetën dhe prapaskenën, komiken dhe dramatikën njëkohësisht, e cila jo rrallë ndodhte të merrte përmasa tragjikomike dhe natyra e jetës amerikane ishte e mbushur me të gjitha, nga mjerimi te brilantet, nga sadizmi te dashuria, nga pislëku i periferive deri te shkëlqimi imponues i kupolave qiellgërvishtëse, nga e njohura dhe e panjohura e shpallur andej-këtej me zë të lartë, deri te misteri i errët i hapësirave ku sundonin shpirtrat e humbur, nga shëmtimi dhe qesharakja e kronikave rozë, deri te bukuria dhe vlera e të gjitha këto, mbeteshin një fatalitet i pashmangshëm, prej të cilit askush s'mund të arratisej.

Zakonisht Eli besonte tek e bija, por nuk ndihej e qetë edhe para një dyshimi sado të vogël. Vendosi të fliste për këtë me Sofinë dhe Klarën. Fiona e respektonte opinionin e tyre, ndaj më e qetë nga ajo mundësi referimi, e cila premtonte në çdo rast një zgjidhje të pranueshme, vazhdoi punën me intensitetin e kërkuar. S'mund të thoshte edhe për sa kohë do t'i duhej ta bënte, ende shumë larg profesionit të saj, atij të doktoreshës pediatre. Fakti se nuk ishte e vetme në atë rrugë, ku përkushtimi i Maksit, gjithashtu, inkurajonte dhe i paraprinte fuqishëm qëndresës së familjes së tyre, ushqente shpresën, forconte besimin dhe i ndihmonte të mos pendoheshin për atë që kishin zgjedhur të bënin. Ata e kishin një punë të sigurt, ndërsa Fiona mbështetjen e tyre dhe studime cilësore. Gjithçka po shkonte ashtu si dëshironin, duke justifikuar edhe shpërnguljen.

\* \* \*

Ishte një e diel e bukur qershori, një nga ato ditë që të ndihmojnë të besosh dhe ta duash më shumë jetën. Sofia u ngrit të përgatitej për në kishë. Billi do të vinte për t'i shoqëruar sipas rregullit të njohur. Zakonisht mëngjesin e hanin të lehtë dhe nuk i duhej të preokupohej në kuzhinë, ndërsa drekën do ta hanin vetëm pas predikimit të së dielës. Fatmirësisht ata e kishin pëlqyer dhe, më pas, kur mes disa të ftuarve në një mbrëmje të ngrohtë familjare, mamaja e Billit, dhe njëkohësisht edhe zonja e shtëpisë, kishte pohuar se s'mund të bënte asnjë çast pa Sofinë, ajo filloi të besonte se një dritare e re po hapej në jetën e saj. Billi vazhdonte t'i vizitonte shpesh dhe në përgjithësi Sofia lundronte në një gjendje të qetë dhe të sigurt, mund të thoshte edhe të gëzuar, megjithëse pas çdo lidhjeje telefonike me familjen, një jehonë e keqe ngrihej dhe sundonte humorin e saj, me pohimin e pashmangshëm se ajo do të mbetej e huaj midis tyre, por çuditërisht, realiteti do ta mbyste shpejt atë rezistencë të pavullnetshme dhe ajo do të humbiste përkohësisht, për t'u rishfaqur pas një telefonate të re nga vendlindja. Gjithsesi, largësia dhe ngarkesa e përditshme, po e zbehnin disi imazhin e dikurshëm, apo ishte vetë ajo që e refuzonte, për të mos mbetur viktimë e së shkuarës?! Prindërit e saj e kishin të domosdoshme ndihmën financiare, ndërsa motra më e vogël, Emma, e dashur dhe ledhatare, e cila kishte moshën e Fionës, në fund të çdo bisede nuk do të harronte komentin për fatin e Sofisë dhe paraajsën

ku ndodhej e motra. Edhe pse nuk mendonte ashtu, Sofia s'mund të shprehej më gjatë, sepse edhe kohën telefonike e kishte të kufizuar, nxitimthi i premtonte se do t'i dërgonte dhurata dhe ndoshta shumë shpejt do të kthehej për t'i parë, por se kur, as ajo vetë nuk e dinte.

Edhe atë mëngjes, Billi u paraqit korrekt dhe shumë i dashur.

- Sofia, besoj se e dini kur fillon ceremonia e së dielës, apo jo? Nuk më pëlqejnë vajzat gjumashe!

- Do të jem atje në moment! - nxitoi të përgjigjej ajo dhe pas pak doli ta përshëndeste. Vuri re se ai ishte bërë disi më i hollë dhe padashur imagjinata skicoi sërish përkrah tij figurën kundërvënëse. Kishte kohë pa e parë mikun e viteve të rinisë, ai ishte një figurë tepër simpatike, atëherë ajo kishte pritur për të, por a kishte pritur vërtet? Apo ndoshta vazhdonte të priste?! Po, përse pikërisht tani, përse këtu? Dhe ngurroi të sillej sipas mënyrës së njohur, tashmë rituale të takimeve me Billin. Ai e thirri sërish, sikur të mos e kishte para syve. Pastaj puthi të ëmën, ndihmoi të atin të vishte xhaketën, kërkoi diçka të ngrohtë në kuzhinë dhe i ftoi menjëherë të dilnin, me një lëvizje të këndshme solemniteti. Kishte një energji të habitshme, shpesh mbresëlënëse dhe ndodhte që Sofia, të ndihej shpesh, si një nxënëse para mësuesit.

Edhe atë ditë, ai do të sillej ashtu deri në fund. Ajo gjithashtu nuk mundi të shkëputej as edhe një çast të vetëm, nga ndikimi i prezencës dhe humorit të tij. Donte të mos ta bënte, por mbeti deri në fund e lidhur pas së kundërtës

dhe vetvetes. Mes takimeve të rastit dhe përshëndetjeve kalimtare në hollin e kishës, Sofia sërish nuk mundi të injoronte një fytyrë të padëshiruar dhe aq të njohur, provoi ta shmangte kontaktin, por ishte e pamundur, sepse tjetra po e priste.

Sofia u lut heshtur të mos ishte ndodhur aty, pranë asaj krijese aq të zhurmshme, e cila vazhdoi të shprehej me zë të lartë, me po ato fjalë dhe mënyrën e njohur.

- Ah, sikur të isha në vendin tënd, do ta shihnin ku do të arrija, por ja që fati ngatërrohet keq ndonjëherë dhe bie atje ku nuk dinë ta vlerësojnë, atje ku e shkelin dhe plaken pa e njohur. Hë, pra, ku mbeti filozofia, shkundu Sofia, mos e lër Billin të presë kaq shumë! Ha-ha-ha, sa e ngathët më dukesh! Gjynah, për Zotin, gjynah! Apo nuk dimë ende asgjë?! - dhe tjetra e mbërtheu Sofinë me sytë e hapur tej mase. - Hë, pra, më thuaj Sofia, më thuaj bukuroshe, kam goditur në shenjë? E gjeta më duket!

- Je e paimagjinueshme, - filloi Sofia, por tjetra nuk e la të shkonte më tej, sepse e kishte kuptuar gjendjen e re të Sofisë.

- Oh, mos, mos më thuaj se s'ka ndodhur asgjë! Sa pak do të shohësh, sa poshtë do të mbetesh, përkushtimi modest me emrin Sofi! S'po të vlen aspak filozofia, e dashur? Hë, pra, mos jam gabim?

- Sa mirë që s'mendojmë të gjithë njëllor! - dhe Sofia kthehu krahët në pamundësi të përballonte revoltën e pashprehur. Ndjeu sytë e tjetrës ta ndiqnin me po atë lumë fjalësh dhe nxitoi të dilte prej andej. Nuk vlente

asnjë përpjekje për t'u ngritur mbi atë arsytim aspak të rastësishëm. Sipas Sofisë, të tilla krijesa, ishin të destinuara të mbeteshin viktima të lakmisë dhe verbërisë njerëzore, duke provokuar fatkeqësisht, në një mënyrë aq sugjestive edhe shumimin e qelizave të tyre, duke shkelur me shpërfilljen ndaj ndjenjës edhe mbi të tjera viktima të pavetëdijshme. Por tjetra s'mund ta kuptonte, ndaj zgjodhi t'i kthente krahët pa e përshëndetur. Billi po e priste pak më tej me buzëqeshjen e përherëshme dhe ajo u ndje fajtoare, edhe pse ai, nuk kuptoi asnjë fjalë nga gjuha e tyre.

Për herë të parë e preku dyshimi se ndoshta gjithçka e rrethonte, përfshirë atje edhe prirjen klasike që udhëhiqte prej shekujsh njerëzimin, pjesë e së cilës asnjëherë nuk do të bëhej, po e pengonte të merrte të plotë dhe pa ndjesinë e pendesës, atë që i përkiste në rrugën e saj. Apo ndoshta edhe një pjesë e pasigurisë personale, buronte pikërisht prej tendencës që e karakterizonte atë vetë, për t'iu kundërvënë dobësive njerëzore? Por, a ishte e drejtë të ngrihej mbi veten dhe jetën e saj?

- Qëndrojmë edhe pak Sofi, - e shkëputi zëri i Billit, - mund të përshëndetesh me të gjithë, presim nëse dëshiron!

- S'është e nevojshme, shkojmë Bill.

- Vërtet? Mjafton për sot?

- Po..., sigurisht, - këmbënguli ajo, - por dua të them se, sot kam të drejtë të kthehem pak te Klara!

- Kaq shpejt të mori malli? Kanë kaluar veçse disa ditë pa e takuar!

- E po, ajo është familja ime këtu!

- Vetëm për pak kohë, edhe ti do të martohesh një ditë, Klara gjithashtu! - guxoi të kërkonte më tej ai, me një vështrim tejet miqësor dhe aq të njohur për Sofinë. Ajo nuk reagoi menjëherë, por ndjeu të prekte sërish një nuancë të re ne sjelljen e tij, tingëlloi më i afërt dhe shumë i dashur, ndërsa ajo përsëri do të ngurronte të afrohej. Përse vazhdonte të largohej duke kërkuar një tjetër emër, aq larg rrugës së vjetër? Ai me siguri e kishte harruar, ajo gjithashtu nuk e thirri asnjëherë dhe vetëm tani po mundohej të mbështetej mbi një ngrehinë që ndoshta nuk kishte ekzistuar, ashtu duhej të ishte, sepse rrallë ndodhte të kalonte para një vlere pa e prekur atë dhe intuita e saj nuk gabonte! Pra, s'ishte veçse imagjinata, apo edhe një subjekt i panjohur referimi, një mjet ndihmës për t'iu shmangur ndjenjës, për të dalë në fund nga vetja. E përse po e bënte, a ishte e domosdoshme ajo kundërvënie e hapur ndaj vetes dhe tjetrit? Dhe, përse duhej, nga kush po largohej? Ndoshta i duhej për momentin, sepse ndihej çuditërisht e pasigurt, si asnjëherë më parë.

Te Petri i dikurshëm mund të thoshte se njihte çdo detaj, deri edhe tek ora kur zgjohej në mëngjes, apo ushqimi i preferuar, asgjë nuk ishte fshirë nga kujtesa, ndërsa te Billi e kishte të vështirë të besonte dhe të mbështetej. Vizioni i saj ishte thujse sipërfaqësor, nuk dinte asgjë për të kaluarën dhe jetën private të tij, kishte parë vetëm fotografi të familjes dhe fëmijërisë së tij, kishte dëgjuar edhe disa karakteristika të pjesshme nga prindërit e disa të njohur të vjetër, mund të thoshte me siguri se ndihej mirë në shoqërinë e tij dhe këtu mbaronte gjithçka.

Ndërsa atë të diel, ai dukej vërtet ndryshe dhe intuita e saj asnjëherë nuk gabonte, por mbetej pa dyshim shprehje respekti dhe afrimiteti të natyrshëm, një komunikim miqësor, një sjellje e bukur në fund, apo ashtu i pëlqeu ta vlerësonte atë moment!

Dikur kishin ecur aq gjatë me Petrin, por ai asnjëherë nuk kërkoi prej saj, ndoshta sepse edhe kur realizohej kjo midis dy të rinjve, vlerësohej rëndom si një hap vendimtar në lidhje, si akti që duhej të finalizonte një bashkim përfundimtar dhe të përhershëm, të cilin edhe opinionioni shoqëror e brohoriste dhe duhej ta pranonte si të tillë. Një shkëputje, apo një rivlerësim për arsye të njohura ose jo, do të thoshte që protagonistët të konsideroheshin të dështuar dhe mund të ndodhte që një pjesë e tyre edhe ta vuante këtë. Ishin pre e fatalitetit të kohës, apo të paaftë të ngriheshin mbi kornizat e një mentaliteti të injektuar artificialisht dhe kushedi përse mbi kokat e tyre! Apo ndodhte se, të ndërgjegjshëm për pasojat, kishin zgjedhur të bashkëjetonin me opinionin? Ajo mund të pohonte se mbeteshin të gjitha, por s'mund të thoshte se çfarë do të kishte zgjedhur ajo vetë, në rast se Petri do të kishte kërkuar prej saj, por ndoshta as ajo vetë nuk kishte pritur, ashtu duhej të kishte qenë. Përfundimisht mbi po atë rrugë, Sofia fatmirësisht s'kishte lënë asnjë gjurmë dhe ndihej mirë për këtë, por përse po rikthehej atëherë, për t'u kapur pas një emri që dikur s'i kishte thënë asgjë përtej një miqësie?

Në letrën e fundit u shkruante prindërve edhe për familjen ku punonte, atje përshkrimi i portretit me emrin

Bill, zinte vendin kryesor. E kishte bërë natyrshëm dhe kur, më pas, ata e pyetën për marrëdhënien me të, kuptoi çfarë kishte shprehur padashur. Emma, gjithashtu, nuk harronte asnjëherë komentin për fatin e së motrës. Atëherë, Sofia ndiente edhe më të fortë nevojën për t'u shprehur, për t'i thënë se jo çdo gjë ishte ashtu si mund të dukej nga larg, se paraja dhe komoditeti, pavarësisht varësisë së pashmangshme që kemi, jo gjithmonë mund të na bëjnë të lumtur edhe pse shpesh, fatkeqësisht, janë ato dhe vetëm ato copa letrash, që përcaktojnë dhe unifikojnë qëllimin e ekzistencës njerëzore, ajo duhej t'i thoshte gjithashtu, se shpirti s'mund të ushqej vetëm me shkëlqimin e realitetit përballë nesh, por me pasqyrimin dhe ndjesinë që përcjell mbi ne, rrezatimi i tij, mbështetur tek aftësia njohëse, apo mënyra e perceptimit. Sipas Sofisë, prirja pozitive do të unifikonte krejtësisht dhe në mënyrë të natyrshme harmoninë mes vetes dhe të tjerëve mbi po atë rrugë, në të kundërt konflikti do të mbetej i pashmangshëm.

E, ndërsa i shprehte të gjitha këto mes emocioneve dhe një drite të re, për të inkurajuar përditshmërinë e së motrës dhe për të kthjelluar njëkohësisht edhe paqartësinë brenda vetes, ajo grua po përfshihej çdo ditë e më fort në angazhimet e detyruara dhe jetën e familjes ku punonte, ndërkohë që do të vazhdonte të shprehte me optimizëm pikëpamjet e saj në shoqërinë e Fionës dhe të Billit. Eli do të mbështeste jo pa qëllim miqësinë mes tyre dhe do t'i ndiqte në heshtje hapat e rinj të së bijës. Mbi to, zëri i fortë i Klarës, do të ushqente adrenalinën dhe shpirtin e aventurës.

Ndërkohë që Sofia përjetonte ende emocionet e asaj dite intensive, Klara ishte preokupuar seriozisht për darkën e së dielës. Gatoi supë me gjoks pule, biftekë me garniturë, salcë, majonezë dhe patate të fërguara, si dhe kremkaramel, ëmbëlsirën e preferuar të Sofisë. Shkëmbenin telefonata të shkurtra gjatë javës, ndërsa darkën e së dielës preferonin ta hanin ngadalë, duke dashur të zgjatnin sa më shumë ato momente intimiteti, por Sofia çuditërisht po vonohej tepër atë mbrëmje. Filloi të dyshonte se diçka ishte ndryshe, ajo e njihte mirë korrektësinë e shoqes, kur mrekullisht heshtjen e gjatë e theu tingulli i ziles së derës, por ishte Eli.

- A mund të jem e mirëpritur për një kafë?

- Ke ardhur në kohë, e dashur, më çmendi vetmia sot!

- Po, Sofia? Ku ndodhet tani?

- Ja, po e pres, por çuditërisht po vonohet, dhe kush se? Sinonimi i korrektësisë! - kur në fjalët e saj telefonoi vetë Sofia. Iu lut ta falte për vonesën, por atë të diel do t'i duhej të mungonte. Më pas, u mundua t'i shpjegonte shpejt, se ndodhej ndoshta para një akti të rëndësishëm dhe se do të dilte me Billin.

- Hej, Klei si të duket, më thuaj? - kërkoi ajo lejen e Klarës.

- Edhe shumë vonoi, më pëlqen Billi!

- Seriozisht, të lutem, ndihem si para një provimi!

- Ç'kërkon tjetër nga unë, e dashur filozofe, më duket se po më fillojnë dhimbjet e stomakut, aq gjatë të kam pritur. Është edhe Eli këtu, të bën të fala, të urojmë një mbrëmje të bukur. Dhe, mos na harro, ti e di ç' dua të them!

Qeshën edhe pak me njëra-tjetrën dhe në fund Klara e kuptoi. Sofia ishte dashuruar me atë burrë simpatik dhe shumë të sjellshëm. Klara e kishte takuar rastësisht gjatë një vizite të shkurtër në shtëpinë e prindërve të tij. Ruante një përshtypje të këndshme, por nuk bëhej xheloze, kishte qenë gjithmonë larg asaj ndjenje, fuqia dhe tingujt agresivë të së cilës mund të shkatërronin pa dyshim një mbretëri. Te Billi, gjithashtu, brenda kontureve fillestarë të njohjes, ajo kishte vlerësuar figurën e tij dhe mënyrën e komunikimit, por asgjë më tepër. Ndjeu mall për Sofinë, ia tha edheELIT.

\* \* \*

Kishte kaluar mesnata, por Sofia nuk ndihej e lodhur. Pas një darke speciale me Billin, në shoqërinë e shumë fytyrave të panjohura, tërheqëse ose jo, vazhduan të pinin ngadalë koktejin e preferuar dhe të flisnin duke pyetur dhe plotësuar njëri-tjetrin në harmoni të plotë me veten dhe ata që i rrethonin. Zakonisht kur dilnin me Klarën, ato preferonin pije të lehta, por atë mbrëmje Sofia po pranonte çdo gjë, që po i ofronte ai burrë bujar dhe aq interesant. Ndodheshin në një ambient intim dhe shumë të rehatshëm të një restoranti italian, preferencë dhe zgjedhje e Billit gjithashtu. Po i shoqëronin tinguj të lehtë, me një shtrirje të këndshme dhe portrete që rrezatonin kënaqësinë që u dhuronte jeta. Mund të pohonte se për herë të parë në atë vend të ri, ku ajo ndodhej vetëm prej disa muajsh, po përjetonte ndjesi të harruara.

Vetëm disa orë më parë, Sofia lëvizte dhe mendonte aq larg asaj gjendjeje tepër befasuese, s'kishte pritur t'i ndodhte aq shpejt, ndaj guxoi të pohonte se ndoshta po ndodhte vërtet një mrekulli, e cila ishte pa dyshim vazhdimësi, jo vetëm e zgjedhjeve të saj. Ishte pjesë e paracaktuar e jetës në rrugën me emrin Sofia, ndaj s'mund të quhej thjesht një rastësi. I pëlqente të thoshte shpesh se, për të marrë maksimumin, duhej të besonte dhe të shpresonte deri në fund, se në çdo hap përpara priste e panjohura, që duhej të zbulohesh dhe përjetohej vetëm prej saj, pavarësisht se asnjëherë s'mund të ngrihej mbi të edhe pse mund të dukej ashtu.

Ata të dy, ndoshta nuk do të ishin takuar kurrë, po të mos ishte larguar nga vendlindja dhe ajo, sigurisht që nuk do ta kishte bërë, po të mos kishin ndodhur ndryshimet tashmë të evidentuara, të cilat gjithashtu kishin pa dyshim shkakun e tyre dhe se ai shkak, mbetej pasojë e një gjendjeje të mëparshme dhe se ajo gjendje ndoshta, ishte krijuar apo provokuar nga një tjetër komunikim fatal, nga një tjetër marrëdhënie dhe varësi e paracaktuar të ndodhte. Pikërisht ajo rrjedhë quhej jetë, me të njohurën dhe të panjohurën, ku edhe këto, me influencën e tyre, pavarësisht nga vullneti, nga pasioni, apo edhe veprimi i pavarur, kur edhe ky mund të ndërthurej dhe shpesh ndodhte të humbiste nëpër labirintet e realitetit, mbetej fati, mbetej ajo forcë që nuk varej aspak prej krijesave të ndërgjegjshme.

Ajo nxitoi t'ia shprehte edhe Billit ato ndjesi. Ai dëgjonte dhe aprovonte heshtur, mbështetur në dritëhijen e butë dhe aq paqësore të atmosferës, ku vazhduan të argëtoheshin deri

pas mesnatës. Sofia ishte e bukur. Ai burrë kishte njohur shumë fytyra të bukura, kishte parë dhe shijuar shumë nga misteri i trupit të një gruaje, por asnjëra prej tyre nuk shprehej si Sofia, asnjëra prej tyre nuk kishte prekur esencën që ai personalisht, kërkonte të gjente dhe vlerësonte te një grua e bukur, thellësinë e mendimit dhe mënyrën e perceptimit. Fatmirësisht e kishte gjetur, e gjeti kur nuk e priste tek ajo grua, e cila ishte nisur drejt tij, nga një vend i panjohur, me emrin e bukur Albania. Ishte i sigurt, ai do ta pëlqente atë vend, përderisa atje kishte lindur krijesa, me të cilën u dashurua që në takimin e parë, mësuesja e filozofisë me emrin Sofia. Dhe guxoi ta pyeste.

- A ndihesh mirë në shoqërinë time?

- Preferoj ta dëgjoj së pari nga ti!

- Mendoja se do ta kishe kuptuar, unë e kam shprehur dhe ti ke intuitë kaq të hollë. Jam kaq transparent para teje!

- Ne dimë pak për njëri-tjetrin, megjithëse unë ndihem vërtet mirë kur jam me ty dhe, më merr malli! Nuk di përse, ndoshta sepse më mungojnë shumë gjëra të njohura dhe të afërta, më mungojnë marrëdhënie dhe imazhe ku gjeja veten dikur. Kjo mund të jetë kalimtare, por më duket se kam filluar të reflektoj ndryshe dhe për t'iu shmangur kësaj, provoj që çdo kontakt të ri ta lidh menjëherë me një pasqyrim të dikurshëm, me ndjesinë se ashtu do ta kem më të lehtë ta pranoj, kështu më ndodh, por gjithsesi, është bukur të ndihem ndryshe, veçanërisht në shoqërinë tënde.

- Po, për mua, Sofi? A ke gjetur një përshtatje pak a shumë të pranueshme? - qeshi ai me ndjeshmërinë e Sofisë dhe mënyrën e zakonshme të të shprehurit.

- Besoj se po... Është një njohje e hershme.

- Ja ku jemi! A mund të më ndihmosh me disa detaje, e bukura Sofi? Pa më keqkuptuar, sigurisht, nuk dua të gjurmoj aspak në të kaluarën tënde!

- Ishte shumë simpatik, - filloi menjëherë Sofia, - mendoj edhe i zgjuar dhe shumë i sjellshëm me mua, por nuk mundëm të shkonim më larg, kam vite pa e parë... E kujtova padashur gjatë takimit tonë të parë.

- Kuptoj, kuptoj, Sofia! Mendon se ke qenë e dashuruar?

- Jo, nuk është kjo, s'ka qenë asnjëherë, sepse kur u ndamë, secili në rrugën e vet, unë nuk e ndoqa, nuk e kërkova, megjithëse vazhdoj të ruaj kujtime të bukura. Ishte një mik i mirë në fund dhe njeriu gjithmonë ndien nevojën e një zëri të ngrohtë dhe të afërt, ku mund të mbështetet lirshëm, mund të japë dhe të marrë nga shpirti i tjetrit. Unë e gjeja këtë tek ai, pa asnjë shpërblim.

- Dhe kjo do të thotë se edhe unë jam një mik i mirë, Sofia? Apo gaboј nëse shprehem kështu?

- Aspak, po bën gjënë e duhur! Është kënaqësia ime!

- Dhe kjo do të thotë se, mund të shkojmë më larg nga ku keni qenë me, më ndihmo për emrin, të lutem...

- E quanin Petri, - vazhdoi duke qeshur ajo dhe zgjodhi një shprehje të huazuar prej tij, - jeni tmerrësisht drejt z. Dagllas!

U mbështet më pas në sytë e tij, ai ngriti menjëherë gotën dhe kërkoi të sajën, ndërsa tingujt e pianos dhe zëri pasionant i këngëtares, arrinin tek ajo të butë e të largët. Ndihej e pushtuar nga emocione të forta dhe harmonia e momentit.

- Për një natë kaq të bukur dhe për një grua të rrallë, si ti, Sofia! Ndihem kaq mirë sonte!

- Për një burrë special dhe kaq të dashur! - dhe ajo u zgjat shpenguar të kapte puthjen e tij. E lëshoi veten në krahët e pasionit dhe të asaj nate me aq shumë ngjyra, pas së cilës marrëdhënia e tyre do të hynte vrullshëm në horizontin e një kontakti të fortë dhe një lidhjeje serioze.

\* \* \*

Billi po kthehej pothuajse çdo ditë në shtëpinë e prindërve. Sofia filloi të shkante më rrallë te Klara, por pozita shoqërore mbeti po ajo dhe ndoshta sepse nuk shiheshin si dikur, ajo ndjenjë u bë edhe më shprehëse. Fionës gjithashtu, i mungonte së tepërmi Sofia, edhe pse ajo mund t'i telefononte herë pas here dhe në fund arriti një moment i sforcuar, kur të gjitha e pranuan se s'mund të bënin aq gjatë pa njëra-tjetrën. Sofia ia përcolli mesazhin edhe Billit. I tregoi sa shumë i mungonin mbrëmjet kur shëtisnin me Klarën, i tha sa i mungonin Eli, Maksi dhe portreti i Fionës, ajo dëshironte t'i takonte më shpesh, ata ishin bërë pjesë e jetës së saj, pa të cilën do të endej e gjymtuar.

- Mund të ma përcaktosh më qartë këtë, e dashur? - u kthye Billi me një orvatje të sforcuar për të ruajtur një shprehje serioze. Sipas tij, Sofia nuk kishte arsye ta kërkonte atë, por ta bënte. Ta ndalonte, ishte si të prishte imazhin e tij për jetën dhe nevojën e natyrshme shpirtërore. A s'po bënte edhe ai të njëjtën gjë? Sepse pas lidhjes me Sofinë,

asgjë nuk ndryshoi në sfondin e marrëdhënieve shoqërore të tij, me të vetmin përjashtim të domosdoshëm dhe tepër organik për personalitetin e trashëguar, ai ndaloi së kërkuari atje dëshirën dhe kënaqësinë që gjeti pranë emrit Sofia dhe do të donte të vazhdonte ashtu deri në fund.

- Mund të flasim më seriozisht, Bill?

- Më fal, Sofia, por tingëllon kaq qesharake! - dhe ai provoi të shkonte më tej, i kënaqur me idenë e re për të luajtur pak me Sofinë.

- Po më dukesh si një fëmijë naiv, e dashur! Mos duhet të kërkoj ku mbeti Sofia që njoh?

- Ashtu?! Mbetet pikërisht kjo, ajo që do të më thuash? Është korrekte çfarë po dëgjoj?

Qëndrimi i saj e ndihmoi të mos tërhiqej. Sipas tij situata po bëhej mjaft argëtuese.

- E urrej gënjeshtren, Sofia, dhe ti e di mirë këtë! A mund të jesh më e sinqertë për Klarën, apo edhe për Fionën? Thua se të mungon portreti i saj, apo jo? - vërejti se fytyra e Sofisë ndryshoi ngjyrë, por ai përsëri nuk u tërhoq.

- Çfarë fshihet pas duetit, Sofia-Klara dhe ndoshta..., ndoshta edhe më tej, pas atij Sofia-Fiona?! Përse kjo thirrje, përse ky alarm Sofia, mos po të dukem i rëndomtë në krevat?

Sofia nuk po gjente çfarë duhej të thoshte. Fjalët e tij, si të kishin efektin e një shuplake, e bënë të skuqej. Billi vazhdoi të ruante seriozitetin me përpjekje të sforcuara. Ajo mbeti në udhëkryq.

- Vetëm këtë nuk e kisha menduar se mund ta gjeja te ju!

- reagoi befas ajo në numrin shumë.

- Më qartë, Sofia, mund të shprehesh lirshëm, e dashur!  
- shkoi më tej ai, me lojën e improvizuar në mënyrë aq spontane dhe argëtuese njëkohësisht, ndërsa Sofia s'po kuptonte asgjë.

- Si mund ta thoni këtë! S'kam qenë kurrë atje dhe vizioni im për konceptet e tua ka qenë kaq larg së vërtetës! Më befasuat, dhe ndihem e zhgënjyer! O Zot, çfarë absurditet!

Ai s'mundi të përmbahej dhe qeshi fort, aq fort sa Sofia mbeti sërish pa fjalë, pa kuptuar dhe pa ditur si ta vlerësonte atë qëndrim disi anormal. Çfarë po ndodhte? Ishte e pamundur të kishte gabuar! Intuita asnjëherë nuk e kishte tradhtuar! Përse duhej të ndihej aq keq dhe përse aq vonë? E, në rast se...

- Oh, Sofi, ha-ha-ha, eja këtu vogëlushe, - e tronditi sërish zëri i tij, - duhet të rritesh, ha-ha-ha, po, po, duhet të rritesh! O Zot, qesha si kurrë ndonjëherë, por e vërteta është se je pak naive, ha-ha-ha, më vjen keq, por duhet ta pohoj këtë!

- Po luan me mua?

- Sofia! E bukura Sofi, përse pyet për gjëra që nuk duhet të pyesësh, e dashur? Përse kërkon leje për atë që është brenda teje? Po të them se nuk duhet ta bësh herë tjetër, se do të dukesh e vogël, e vogël dhe mund të më humbasësh nga sytë pastaj!

- Ishte vetëm shprehje respekti, por gjithsesi, po mundohem të kuptoj, sigurisht, nuk e dija këtë përcaktim...

- E shoh, u mërzite me mua! Mjaft më, ishte një shaka, qesha kaq shumë sot! E mbyllim këtu.

Por, Sofia nuk mundi të kalonte. Ishte vërtet një shaka, apo një përshtatje e zgjuar për të dalë shpejt nga tuneli?

S'kishin folur asnjëherë për gjërat ndryshe, mos ndoshta ishte zhytur pa menduar gjatë, se çfarë mund të gjente poshtë sipërfaqes së kaltër? Duhej të shfrytëzonte momentin.

- Nuk jam e mërzitur, por nuk po kuptoj se përse zgjodhe një detaj si ky, kaq ekstrem! Dhe të panevojshëm në fund.

- Sepse atje, e dashura ime, kishte elemente brenda kërkesës sate, fare e thjeshtë! Improvizova një lojë të vogël me ty, kaq!

- Ndërsa unë s'mund të sajoja kurrë një situatë si kjo, thjesht nisur nga një element i rastësishëm, pa asnjë përjasje apo varësi të njohur. Interesante kjo! Paske aftësi të admirueshme Bill, vërtet fantastike! Vetëm tani fillova të të njoh, sa keq!

- Do të thuash se nuk di asgjë për këtë koncept apo *element fiziologjik* në natyrën e qenies njerëzore, e dashur?! - filloi sërish ai me një buzëqeshje të lehtë, por i kujdesshëm me zemërimin e saj.

- Oh, mos, të lutem, Sofia, tingëllon sikur të kesh zbritur nga bota e engjëjve, e dashur! Mos kam humbur edhe diçka tjetër?

- Problemi, mendoj, nuk është se çfarë dimë z. Dagllas, por e rëndësishme mbetet se çfarë bëjmë dhe kjo influencë është zero tek unë, z. Dagllas, - përsëriti ajo, - por e kam të vështirë të besoj se keni bërë po atë që kam bërë unë! Gjithsesi, më detyroheni një shpjegim.

Ai kapì nuancat e para të pakënaqësisë dhe intolerancës. Duhej të ndalonte dhe të rivendoste gjendjen normale, ndaj i kërkoi Sofisë ta falte, duke i thënë se kishte zgjatur

tepër ajo lojë dhe se mund të hynin shpejt në rrjedhën e zakonshme, por Sofisë i duhej të njihte pikëpamjen reale të tij dhe i premtoi se pas kësaj do të harronte. Ai i kërkoi të dilnin në kopshtin prapa shtëpisë, ndërsa ajo e ndoqi e bindur se ai ishte një burrë i sinqertë dhe shumë i sjellshëm, e përgatitur për një bisedë të këndshme.

Qëndruan pothuajse një orë atje dhe nëpër fjalët e tij, Sofia mendoi se sapo kishte filluar të eksploronte në thellësitë poshtë sipërfaqes së kaltër dhe ashtu, në heshtje dhe me një ndjesi të thellë mirënjohjeje për sinqeritetin e tij, falënderoi Zotin për atë burrë të mrekullueshëm, tek i cili mund të gjente përgjigjet e gjithë pyetjeve të saj. Zëri i tij tingëllonte aq i qetë, aq i njohur dhe aq i afërt tashmë, duke përcjellë tek ajo përvojën e një jete të mbushur plot ngjarje dhe emocione të forta.

Ai vazhdoi t'i shpjegonte se, njihte shumë mirë disa prej tyre, por s'mundej të pranonte se ishte e drejtë përbuzja dhe mënjanimi i tyre në shoqëri. Asnjëherë nuk e kishte bërë këtë, nuk e pranonte kurrësi diskriminimin në një shoqëri të civilizuar. Sipas tij ishin ekstremistë ata që shpreheshin për të kundërtën, por gjithsesi, ai nuk do të mundej asnjëherë ta mbështeste dhe as ta inkurajonte hapur një martesë të ligjshme mes tyre, e cila sipas tij, ndoshta do t'i paraprinte realisht portretizimit të ardhshëm të një bashkëjetese formale dhe aspak korrekte me çfarë përfaqësonte lidhja universale mes një burri dhe një gruaje.

U shpreh gjithashtu, se vazhdonte ta konsideronte familjen tradicionale, si të vetmen bërthamë të shëndetshme për

gjeneratën, i tregoi se ai mbronte fort idenë e një martese të mirëfilltë, energjia e së cilës buronte nga origjina, e prej saj, sipas tij, duhej të ushqejej edhe vazhdimësia e natyrshme e njerëzimit.

- Kam përshtypjen se në shumë raste Sofia, ndodh që individët duan të provojnë, ndodh shpesh të influencohen aty-këtu edhe nga një opinion i gabuar, të cilin vetë bartësit e tij e kultivojnë qëllimisht mbi turmën, e prej këtu fillojnë të shfaqen njollat e kësaj *epidemie*, deri diku edhe denigruese të ndjenjës më të bukur njerëzore, asaj të dashurisë qiellore, sipas meje. Para disa muajsh, më befaso i kërkesa absurde, për të ligjëruar të drejtën e adoptimit të fëmijëve nga çiftet ndryshe. Nuk u pranua, fatmirësisht kishte më shumë zëra kundër se pro, por kjo influencë, nëse mund ta quajmë kështu, mendoj se po përhapet me një shpejtësi deri diku të frikshme. Unë e vlerësoj si një kthim prapa Sofi, pak a shumë edhe si një përçartje universale, si një shenjë regresioni moral dhe shpirtëror mes nesh, apo si një aventurë e kënaqësive seksuale ndoshta... - vazhdoi të shprehej pasionant ai, ndërsa Sofia kërkoi ta puthte, kur ai e surprizoi sërish.

- Mendoj të organizojmë një pritje për miqtë tanë, Sofia. Dua t'i njoh më mirë edhe shoqet e tua, Klarën, Elin, më ndihmo, të lutem...

- Fionën dhe Maksin, - plotësoi vrullshëm ajo me një optimizëm të dukshëm, - sa më gëzove! Sot ka qenë vërtet një ditë me fat.

- Sikur ta vendosim në fund të javës bukuroshe, si mendon, mbrëmjen e së shtunës është më mirë! - dhe ai

kërkoj aprovimin e saj. Ajo e përqafoi sërish, ndërsa ai ndjeu fuqishëm pasionin dhe magjinë që fshihej në dashurinë e një gruaje. Mos e dhëntë Zoti të urrehem ndonjëherë prej saj, u lut ai në krahët e ngrohtë të Sofisë.

Lidhja e tyre po merrte formë dhe ai jo vetëm që ndihej një burrë me fat, por edhe më i ekuilibruar në jetën private, më i qetë dhe i afërt me prindërit. Kalonte më shumë kohë me ta dhe kjo pa dyshim, në sajë të prezencës së Sofisë, për të cilën e merrte malli. Vetëm disa javë më pas, ai i propozoi të merrej vetëm me shërbimet për prindërit, ndërsa pastrimin e shtëpisë tepër të madhe për shpatullat e brishta të Sofisë, do ta bënte një punonjëse e re dhe këmbënguli derisa Sofia u detyrua të bënte ashtu si dëshironte ai. Jeta po u buzëqeshte aq fort dhe bukur, dhe me sa dukej edhe Sofia vetë, filloi të besonte te një mrekulli.

\* \* \*

Fiona përgatitej të festonte njëzetvjetorin. Mbeteshin edhe disa orë nga momenti kur, si zakonisht në raste të tilla, të ftuarit e familjes, mes të cilëve edhe shoqe të saj, do të mblidheshin diku në mbrëmje. Kishte kohë, ndaj vendosi ta përkëdhelte veten. Doli të blinte disa veshje për sezonin. Ajo e dinte se, dyqanet e preferuara të saj, ishin duke reklamuar tendencat e fundit dhe, si përherë, tundimi për të bërë sa më shumë blerje mbetej i jashtëzakonshëm, por paratë të llogaritura e, në fund, mbetej një vetëdije e admirueshme, e cila, si përherë, do të ekuilibronte mre-

-kullisht domosdoshmërinë me mundësinë dhe do t'i impononte menjëherë edhe kontrollin, pavarësisht dëshirës, apo tërheqjes instiktive ndaj së bukurës.

Edhe pse ishte gjë e mirë t'u përshtatej kërkesave të moshës dhe grupit shoqëror, ndodhte ta gjente veten të lodhur dhe shpesh përfshirë edhe nga ndjesi snobizmi të panevojshëm. Atëherë provonte të shkëputej dhe të krijonte një figurë të pavarur prej tij, larg ligjit të pushpallur të grupit përkatës, apo edhe të një rrethi të caktuar individësh, të cilët ndiqnin me një fanatizëm ekstrem modelet dhe referencat e blerjeve. Asnjëherë s'kishte menduar ta bënte, por mbetej e vështirë edhe të ecte indiferente dhe pa dëgjuar jehonën e tregut. Kush e krijonte atë horizont dhe ku mbështetej ajo prirje e ethshme, por edhe të shprehurit nëpërmjet saj? Më e thjeshtë nga ç'mund të dukej.

Dhe për këtë përdorëshin, dhe fabrikoheshin pa limit emrat e shquar, fytyrat e famshme të kinemasë dhe muzikës, mënyra më e gjetur për sytë e adhuruesve jo vetëm të rinj e, më pas, ato portrete të retushuara me një mjeshtëri vrastare, do të serviroshin gjithandej si modeli më i përsosur për t'u ndjekur. Por jo të gjithë e kuptonin atë si një manipulim dhe jo të gjithë e shihnin si një shfaqje surreale për t'i shërbyer industrisë së reklamave dhe botës së konsumit. A duhej të reagonin për të sjellë një ndryshim, a mund ta sfidonte ndokush atë refleksion të papërbalueshëm prirjesh moderniste, i cili ndodhte të konsiderohej art me vlerë absolute? Realiteti mbi kokat e tyre mbetej sfidues, sepse gjithçka funksiononte e pavarur nga nevoja për një

jetesë të thjeshtë, apo për mbijetesë, deri në degjenerimin e pashmangshëm të asaj që konsiderohej nga shumica, kulturë e trashëguar, e domosdoshme dhe e pranueshme, mbështetur fort mbi parimet dhe vetëdijen e kultivuar të krijuesve. Natyrshëm, njeriu nuk mund të shohë më larg se mendimi, apo edhe perceptimi individual dhe se pikërisht prej këtu fillon edhe sundimi i subjektivizmit elitar, ngjyrat specifike dhe zgjedhja e pavarur e të cilit, ndodh shpesh t'i paraprijnë një shëmbëllimi fals, tejet sipërfaqësor dhe ndonjëherë edhe jashtëtokësor në mënyrën e shprehjes dhe trajtimit të figurës.

Fiona kujtoi sërish një thënie të bukur të Sofisë. Është e lehtë të bësh tëndin shabllonin e një figure, që dikush tjetër e ka krijuar, thoshte shpesh mikja e saj, por kjo s'do të ketë vlerë, sepse ti asnjëherë nuk do të ndiesh atë që ka ndier autori.

Fiona kishte krijuar vizionin e vet mbi autorësinë e atij përcaktimi, të cilin e vlerësonte objektiv, ashtu si mjaft pikëpamje origjinale të Sofisë. Ditët nuk i zgjedhim ne, do të shprehej sërish Sofia, por janë ato që zgjedhin mistershëm secilin prej nesh, janë ato që përcaktojnë edhe hapin tonë të fundit, vendin dhe momentin kur do të shkëputemi nga ky realitet dhe ekzistenca vetjake, për të hyrë në një tjetër gjendje sipërane dhe ndoshta prej andej, mund të ndodhë ta gjejmë edhe përgjigjen përfundimtare të misterit të përjetësisë, për të kuptuar se përse jeta mbetet pafundësisht e bukur dhe e pakrahasueshme.

Sa keq që s'mud ta shihnin më shpesh njëra-tjetrën. Por atë ditë ajo preferoi t'i largonte të gjitha dhe zgjodhi të

mbështetej mbi ngjyrat e rrugës, që kishte provokuar ata tinguj mallëngjimi. Vrapoi ta jetonte atë ditë, me ndjesinë se duhej të merrte të plotë, atë çfarë fshihej më pas, duke i thënë vetes se kurrë, kurrë nuk do ta lejonte Fionën të dukej e vogël dhe e lehtë, duke ndjekur si e verbër hijen e një emri që s'mund të bëhej kurrë emri i saj. Koha do të ndihmonte në zbulimin e detajeve dhe ndjesitë mes përjetimesh të reja, do ta bënin më të dëshiruar të panjohurën, në kërkim të përsosmërisë.

Ndërsa ecte drejt banesës së saj, Fiona e konsideroi veten me fat për gjithçka kishte. Ajo do të kapej fort pas dashurisë së tyre dhe do të kujdesej të mos ta humbiste rrugën me tingujt e bukur nga vendlindja. E kishin mësuar ta donte fort dhe ta respektonte veten dhe tjetrin, si autore e së nesërme së përbashkët.

### *Ishulli*

Ai ngrihej tundues, si një smerald i rrallë dhe i çmuar, tepër joshës dhe marramendës, mbi një kaltërsi të thellë dhe të vjetër sa bota, ndërsa ajo, përjetësisht e dashuruar me atë shkëlqim magjepsës dhe misterin e kohës nderur mbi të, vazhdonte të përkëdhelte fytyrën e tij, e kujdesshme ta ruante si përherë, të pastër dhe të paprishur. Njihej me emrin *Ishulli i Palmave*. Nuk dihej me saktësi origjina e emrit të tij, nuk njihej as identiteti i subjektit të parë, i cili

pati fatin të përjetonte atë kontakt përjetësie, me ndjesinë se ishte ulur në fronin e mbretit të gjithësisë, i zgjedhur të transkriptonte mesazhet qiellore, të cilët vetëm ai mund t'i përcillte te tokësorët.

Të tjerë do të ecnin më pas mbi po ato gjurmë, ndërsa koha çuditërisht nuk mundi t'i prekte apo t'i çngjyoste trajtat e asaj frymëmarrjeje të pakrahasueshme. Mbeti i bukur dhe paqësor, duke funksionuar si një organizëm i pavarur nga rrezatimi i horizontit fshehur pas kontureve të kaltra dhe aq të njohura, i vetëdijshtëm për epërsinë e pamohueshme të ekzistencës. Mrekullisht, ai asnjëherë s'e kishte prekur vetminë edhe pse një pjesë e madhësisë së tij e merrte emrin pikërisht nga paqja, që sundonte mbi hapësirën e izoluar prej zhurmave të kohës.

Ndërtesat e vogla turistike, veshur me hijeshinë dhe bujarinë e asaj natyre të virgjër, zbukuruar me dekoracione bambuje, zhytur mes gjelbërimit aromatik nëpër rrafshinën anës plazhit, përcillnin te të gjithë vizitorët e rastit ndjesinë e një parajse tokësore. Një pasuri e vërtetë turistike, tingujt e së cilës do të ushqenin edhe shpirtin me të varfër me bukurinë dhe dashurinë për jetën.

Fiona e zbuloi ndërsa kërkonte te një revistë udhëtimesh, ku reklamoheshin mes fotosh dhe ngjyrash tunduese disa prej vendeve më ekzotike. E tërhoqi menjëherë titulli, rilexoi më pas atë që i interesonte dhe vendosi të zgjidhte. Xhejmsi, i dashuri i saj, çuditërisht e aprovoi menjëherë propozimin pa bërë asnjë pyetje. Do të pushonin atje dy javë. Fiona e adhuronte veçanërisht plazhin, por mbi të

gjitha i duhej të shkëputej së paku përkohësisht, nga një kontakt i bezdisshëm ndërmjet Xhejmsit dhe Gebit.

E kishin njohur atë vajzë në një klub nate dhe Fiona, e cila vështirë se mund të bëhej xheloze brenda natyrës së njohur, përherë me një sens të admirueshëm mase, por edhe aftësinë për të ruajtur ekuilibrin, ndodhte t'i shpërfillte prapaskenat dhe dritëhijet, që do të reflektonte hera-herës realiteti. U afrua me të panjohurën e rastit dhe e pranoi midis tyre, duke e vlerësuar fillimisht si një kontakt interesant dhe të përkohshëm, por Xhejmsi, ai për të cilin s'kishte dyshuar asnjëherë, shumë shpejt do ta befasonte.

- Është mirë të luajmë pak, - i kishte pëshpëritur ai në njërën prej mbrëmjeve të zhurmshme, ndërsa argëtoheshin mes një grupi të njohurish, në qendër të të cilit rrezatonte bukuria fizike e Gebit.

- Në ç'mënyrë, Xhejms? S'po kuptoj! - kishte reaguar e habitur Fiona.

- Mënyra më e qenësishme në këto raste, duket e lehtë Fiona, të lutem!

- Edhe pastaj, çdo të thotë kjo?

- Të luajmë, unë ti dhe Gebi, por nuk dua ta bësh vetëm për mua. Hë, si thua? Mos më refuzo, të lutem, e dashur! Vetëm një herë dhe të premtoj se nuk do të ndodhë më, do ta shohësh! Unë jam njeri që i mbaj premtimet... Do ta bëjmë Fiona?

- Më pëlqen Gebi, por jo në atë mënyrë! - u revoltua e befasuar, Fiona, - edhe e dehur nuk do ta bëja! Vërtet po ma kërkon këtë? - gati sa nuk thirri ajo.

- Po, por nuk mundem pa dëshirën tënde, të lutem, do të jetë interesante, më beso!

- S'mundem të pranoj, çfarë po thua kështu, është komplet jashtë përmbajtjes sime! - dhe ajo kishte pritur që ai të kuptonte, por nuk ndodhi.

- Nuk do të mërzitësh nëse unë, dua të them... Vetëm një herë, ndoshta! Duhet të të mjaftojë sinqeriteti im! Nuk dua të bëj asgjë pas krahëve të tu, të lutem!

Fiona nguroi të përgjigjej menjëherë, sepse ndihej e zbuluar dhe gati edhe e pambrojtur, në një udhëkryq të panjohur.

Ishin njohur para disa muajsh, mes spektatorëve të shumtë në një ndeshje basketboli. Fionën e kishte tërhequr menjëherë fytyra simpatike dhe mënyra e paraqitjes në publik. Marrëdhënia e tyre, hap pas hapi po i rezistonte natyrës së njohur dhe gjithçka kishte qenë interesante, deri në momentin kur ai kërkoi prej saj të pashprehurën mes tyre. Horizonti u mbulua me një hije të panjohur dyshimi, por edhe pse Fiona kishte aftësinë të kontrollonte dallgët shpirtërore dhe t'i mbante përkohësisht ato nën pushtetin e arsyes e sigurt se në fund, fati i së nesërme do të vendosej me siguri në duart e aftësisë njohëse dhe ndjenjës së papërballueshme, mbeti pa fjalë, pa njohur as veten. Heshti edhe pse ishte gati të godiste dhe çuditërisht e pranoi atë rol inferior në dukje, edhe pse tepër e turbulluar, ndërsa guxoi t'i mbyllte sytë para revoltës së Fionës, që luftonte brenda saj. Dhe ajo paqartësi vazhdoi ta ndiqte pa e lejuar të zgjidhte veprimin edhe për shumë kohë.

Dhe loja do të arrinte deri në cakun e fundit, fatmirësisht pa e kaluar atë. A do të ishte larguar, nëse do të kishte ndodhur? Ai nuk mundi, ose ndoshta ishte tërhequr Gebi, e cila i tha Fionës se Xhejmsi nuk ishte aspak modeli që parapëlqente, kurse Xhejmsi në anën tjetër, u shpreh i përvuilur para saj, se e kishte të pamundur të ngrihej mbi dashurinë e Fionës.

Pas atij incidenti, takimet me Gebin i mbetën rastësisë, por Fionës nuk po i ndahej dyshimi, pavarësisht qëndrimit të njohur të personazhit ndërmjetës. Ajo nuk mund të thoshte gjithashtu asgjë për pasojën, nëse Xhejmsi do të kishte shkuar deri në fund me atë vajzë, por vazhdoi të endej pranë tij me një besim të thyer dhe kjo po e torturonte. Filloi të ndihej edhe e lodhur prej atij dualizmi të panevojshëm dhe të pajustificuar, as nga vetja e jo më nga tjetri.

Ndjeu se i duhej diçka ndryshe, ndaj zgjodhi të largoheshin me pushime. Për sa kohë do të qëndronin në ishull, nuk mund të përdornin telefonin personal, ishte rregull për të gjithë. Në rast se duhej kjo, mund ta bënin nga qendra e zonës turistike, një vend i paracaktuar për shërbime të domosdoshme. Kjo do t'i ndihmonte të shkëputeshin përkohësisht nga çdo kontakt i zakonshëm, ndërsa numri i banorëve atje, ishte i kufizuar dhe të gjithë të njohur. Ata shërbenin brenda territorit turistik dhe krijonin atmosferë festive përgjatë mbrëmjeve të nxehta dhe tepër intime. E mrekulluar nga natyra tepër joshëse e atij vendi dhe e lodhur nga gjendja e turbullt midis tyre, po e priste ditën e udhëtimit duke ndier edhe minutat.

Eli dhe Maks, nuk dinin asgjë për tingujt e rinj mes saj dhe Xhejmsit, ndërkohë që besonin plotësisht te fjalët e Fionës. Asgjë për pasigurinë e saj dhe as për qëllimin e vërtetë të atij udhëtimit. Fiona do t'u tregonte për ngjarjet e fundit, vetëm nëse do të duhej ta bënte. Vazhdonte të flinte dhe të zgjohej thellësisht e dashuruar. Nuk e kishte të lehtë largimin prej tij, prandaj i duhej të provonte gjithçka mundej.

\* \* \*

U nisën pas disa ditësh. Udhëtimit filloi me makinën e tyre, vazhdoi me aeroplanin e linjës, më pas me një autobus shumë të rehatshëm turistësh dhe përfundoi me hidroplanin e ishullit. Fionën e ngacmoi një përkundje e lehtë në kontaktin e parë me oqeanin, misterioze, e këndshme dhe e pashpjegueshme njëkohësisht, si të ishte një krijesë që qëndronte pezull mes qiellit dhe ujit, por nuk po i ndahej ende shija e keqe e konfliktit mes tyre. Ndërsa fytyra e Gebit vazhdonte të endej mbi kokën e saj, si një udhëheqëse e padukshme e mendimit, ndërkohë që Xhejmsi nuk po e ndihmonte të harronte.

- Më pëlqen fluturimi, Xhem, dhe është kaq bukur këtu!

- Fluturimi i kujt shpirt? - pyeti ai me shikimin mbështetur diku prapa saj.

- Fluturimi në përgjithësi, paqja në lirinë e qiellit!

- Mund të vij edhe unë me ty? - dhe ai i shtrëngoi dorën, por kjo nuk e preku Fionën.

- Po të jetoje vetëm me mua, pse jo! - provokoi sërish ajo.

Ai kuptoi, por nuk provoi ta ndiqte. Rrezatimi para tyre po merrte trajta më të qarta dhe vetëm pas disa minutash, mes një pasqyrimi të jashtëzakonshëm koralesh dhe bimësie të pasur nënujore, u shfaq kurora madhështore e palmave dhe, në këmbët e tyre, vezullonte nën rrezet e diellit, rëra e bardhë e një plazhi magjepsës. Padashur ata u ngritën njëherësh, para se hidroplani të ndalonte plotësisht. Fiona zbriti e para dhe pothuajse harroi arsyen që e kishte çuar atje. Hoqi nxitimthi sandalet e lehta verore dhe vrapoi mbi sipërfaqen e nxehtë e të pastër të rërës. Pavarësisht sfidës së qiellit, të qenët i mbështetur pas forcës tokësore, mbetej energjia e jetës dhe kuptimi i ekzistencës.

I pritën me gjerdanë lulesh dhe kërcime pagane, deri te prezantimi me banesën e përkohshme të tyre, një kasolle e bukur me thurje bambuje, atje ku mbetën vetëm ata të dy, nën pushtetin e zërave të pyllit dhe aromave të gjelbërimit shekullor. Ai provoi të afrohej i pari dhe fatmirësisht nuk u zhgënjye.

- Shpejt, Fiona, më duhet një e puthur, të lutem, e dashur!

- Ashtu, ashtu krijesë e keqe! - qeshi fort ajo dhe u hodh në krahët e tij. - Mos duhet të kishim këtu edhe... - por ai nuk e lejoi.

- Mos fol, e dashur, mos harro ku ndodhemi! - dhe ai mbështeti dorën mbi buzët e saj. - Tani më duhet vetëm kjo, mbretëresha ime, mos më lër të etur në këtë parajsë.

- Ndoshta nuk do të mjaftonte... - filloi ajo, por ai nuk e lejoi të shkonte më tej.

- Mjaft, mos u bëj e pamëshirshme! - ishin fjalët e fundit të tij dhe ajo u tërhoq plotësisht e përkëdhelur nga pasioni i njohur. A s'kishte pritur aq gjatë të mbetej vetëm me dashurinë e saj? E lëshoi veten në krahët e momentit dhe ngrohtësisë që buronte prej tij.

Fiona u ngrit e para. Ndihej plotësisht e çlodhur pas atij udhëtimit të gjatë dhe çuditërisht shumë e qetë. Xhejmsi vazhdonte të flinte, por ajo nuk e zgjoi menjëherë. Kërkoi dhe gjeti hartën e vendit ku do të pushonin, si edhe një udhëzues ku ishin piketuar qartë vendet e shërbimit, ato të argëtimit dhe disa prej kalimeve kryesore, shoqëruar me pamje tunduese. Ky ishte *Ishulli i Palmave*. Mes rrënojave të një tempulli, e tërhoqi një fushë e vogël shahu, sajuar me pllaka të gdhendura bukur, ku lojtari mund të lëvizte lirshëm midis gurëve të mëdhenj të shahut, për t'i zhvendosur nga njëri kuadrat te tjetri. Ndarjet e gjelbëruara me gurë, ngjanin me një zbulim të hershëm arkeologjik, i cili mrekullisht kishte mbetur i paprekur, nën dritën e përjetshme të krijuesve të hershëm. Ne do t'i prekim këto gjurmë, mendoi ajo me një ndjesi të thellë kënaqësie. Xhejmsi ndodhej atje me të dhe vetëm për atë, por i duhej më shumë kohë për të njohur më mirë atë edhe veten. A do të mundej të shkëputej prej emrit që kishte lëkundur besimin dhe kishte prishur imazhin e pasionit të saj?

Vështroi përreth dhe ndaloi pranë perdeve të bardha prej linoje të lehtë, të cilat shërbenin si mure transparente brenda banesës. Dhe, natyrshëm, ato zgjuan tek ajo mallin për vendlindjen. Nuk mundej ta shpjegonte pse, por nga

dita e njohjes me Xhejmsin, kjo po i ndodhte më shpesh. Ishte nostalgji, apo frikë, ishte pendim ndoshta, pasiguri, apo mungesë ngrohtësie? Lidhej me vendin ku kishte lindur dhe çuditërisht me fëmijërinë dhe njerëz që kishin mbetur atje. Trembej se ndoshta rruga ku po ecte çdo ditë, mund të ndodhte të mbetej e ftohtë dhe e zbrazët, dhe atëherë? Atë rrugë nuk e kërkoi ajo, por e kishin tërhequr drejt saj, duke e mësuar të mendonte se po bënë më të mirën për të, por ajo s'mund t'i gjykonte prindërit.

Pas hallakatjeve të imponuara nëpër terrin e së panjohurës, prindërit e saj arritën të uleshin diku dhe të orientoheshin, nën një ndriçim shpresëdhënës dhe në kushtet e një jetese të thjeshtë dhe të qetë. Fiona, gjithashtu, ishte përshtatur shpejt, nëpër ngjyrat e personalitetit të saj e, megjithatë, sa herë do të ndodhte të përballej me një kontakt ekstrem, apo një sfond thellësisht jashtë natyrës së njohur, dëshira padashur do t'i fluturonte larg, atje ku flitej një gjuhë e panjohur nga Xhejmsi, ai s'kishte qenë asnjëherë në vendlindjen e saj, por sigurisht që do të shkonin atje, vetëm kur Fiona do të ndihej e plotë pranë dashurisë së tij, por a ishte vërtet ashtu? “Prandaj ndodhem këtu, pikërisht për ta njohur më mirë, - i tha vetes, me një qetësi të admirueshme, - për ta njohur atë dhe për të ruajtur të paprekur ndjenjën time.”

Hapi dritaren dhe u spraps e trembur. Mbi gjethen e madhe të një bime tropikale, po lëvizte ngadalë një merimangë e madhe, me këmbë tepër të gjata e tepër të holla, pothuajse të padukshme. Nuk ngjante aspak e rrezikshme e, megjithatë, Fiona e largoi shpejt prej vetes. Vazhdonte të trembej prej

tyre dhe u shmangej si fëmijë. Kujtoi të kishte lexuar diku se shfaqja e merimangës në një ëndërr, ishte paralajmërim për një intrigë rrotull teje, por në jetë pa dyshim mbetej vetëm një specie në llojin e vet. Për të ndihmuar fobinë e pashmangshme, bëri një kontroll të shpejtë rrotull parvazit të dritares, në banjë, pastaj në gardërobë, nëpër qoshet e dhomës, poshtë krevatit prej bambuje dhe, në fund, e kënaqur me rezultatin, doli në verandën prapa banesës.

Atje harlisej si në përrallë një bimësi e shëndetshme dhe e shumëllojshme, ku spikatnin dukshëm akaciet, kaktusi, fikusi dhe në këmbët e tyre një kombinacion shumëngjyrësh i jashtëzakonshëm. Ajri i ngrohtë, dehur me tepri prej nektarit dhe tingujve të pyllit, ku mbretëronin palmat tropikale, që dukej sikur puthnin qiellin, të tërhiqnin marrëzisht në tempullin e natyrës. Parmakët e verandës, sajuar prej thuprash të bardha bambuje, një tavolinë e vogël ovale me ndenjëset e rehatshme dhe tepër të lehta rrotull saj, nën hijen e pakrahasueshme të një çadre dekoruar me motive pagane, përkonin aq butësisht me freskinë dhe hijeshinë e botës përreth, sa dukej e pamundur të besojë se ai vend kishte qenë ndonjëherë pa to.

Ndërsa Xhejmsi po flinte pak si tepër.

- Si mundesh të flesh kaq gjatë, zoti Xhejms, - i thirri ajo, - zgjohu gjumash, hej Xhemi, zgjohu pra!

- Oh, mos, ma prishe ëndrrën, Fiona! - mërmëriti përgjumësh ai.

- Ëndrrën! Ëndrra jote fillon pikërisht tani gjumash, ne jemi brenda saj, ndërsa unë nuk dua të humbas asnjë moment. Lëviz, dembel, do të pres vetëm pak!

- Vërtet, sa është ora? - u mundua t'i mbante sytë hapur ai.

- Një banjë do të na bënte mirë të dyve, nxito, të lutem, dua të njoh parajsën ku ndodhemi. Nuk toleroj të humbas asnjë minutë më tepër.

- Ndërsa unë... O Zot, pothuajse harrova se ku ndodhem!

- Ç'do të thotë kjo? - u kthye menjëherë Fiona.

Xhejmsi nuk kishte shprehur asnjëherë para saj pasiguritë e jetës profesionale, atje ku çdo mëngjes rifillonte me frikën e një dështimi të mundshëm, provokuar shpesh nga ambicie të panjohura, produkt i pashmangshëm i konkurrencës dhe ligjit të xhunglës, mekanizëm i varësive të përditshme financiare, aq të zakonshme në botën moderne, tmerrësisht rutinë, sa ndodhte padashur të bëheshe pjesë e saj dhe çdo nerv i yti do të funksiononte më pas nën tingujt e një rritmi të imponuar brenda atij konstrukti gjigand marrëdhëniesh globale. Ç'nuk do të bënte ai për t'iu shmangur sadopak nëse do të mundej, por s'mund ta shpjegonte konfliktin brenda tij, sepse s'kishte aspak të drejtë ta prishte sfondin e atij momenti, sepse Fionës nuk i duhej aspak pasiguria e tij, aq më tepër mbi atë paqe aq të dëshiruar, ndërkohë që ajo po e priste t'i fliste me mënyrën e njohur, ndaj ai nxitoi ta bënte.

- Kishte aq dritë në ëndrrën time, sa nuk po kuptoja, isha jashtë apo brenda saj, e dashur! Ishe edhe ti atje.

- Fatmirësisht ndodhesh brenda dritës dhe ëndrra jote është kthyer tashmë në realitet. Këtu duhet ta harrosh atë që mbeti pas, atje, mes zhurmës dhe kërkesës pa përgjigje, duhet të pushosh, ndoshta edhe pa menduar.

- Sa mirë do të ishte, do të mundohem, e dashur, të premtoj!

- Për çfarë?

- Të ndiej se jam i pavarur nga askush!

- As nga vetja? - kërkoi Fiona, ndërsa ai u ngrit vullshëm dhe e përqafoi.

- Do të jem i varur vetëm nga ti, shëmtaraqe!

- Ndërsa unë dua të jem krejtësisht e pavarur!

- Edhe nga vetja? - imitoi ai me ton dashamirës.

- Ndoshta, edhe nga ajo, do të provoj!

- Mirë do të bësh, por tani më duhet një banjë dhe një darkë e mirë, zemra ime! Si mendon? Do më lësh të lëviz?

- Përse shmangesh, Xhejms? - këmbënguli sërish ajo.

- Nga kush, shpirt?

- Nga e vërteta, Xhejms, nga e vërteta! - e shtyu ajo pa e lënë të ngrihej.

- E vërteta sipas kujt? Më lësho Fiona, më duhet të lahem, e dashur!

- E vërteta sipas së vërtetës, Xhejms! Të asaj që njohim unë edhe ti!

- Që do të thotë? - qeshi fort ai.

- A do të jesh i pavarur edhe nga vetja? Më duhet kjo!

- Edhe pse mund të duket e pamundur, do të provoj vetëm për ty, por kujt do t'i shërbente kjo në fund? Unë s'do të quhesha më Xhejms Levis, pastaj!

- Do t'i shërbente përsosmërisë, - u hodh në sulm ajo, - por natyrisht, nuk mund të ndodhë kurrë midis nesh, jemi qenie kaq të paafta për të kuptuar se kush është vlera e jetës që na jepet vetëm një herë!

- Vështirë ta përcaktojme, e dashur Fiona, por lëre filozofinë, të paktën këtu! A s'jam këtu ku dëshiroje të isha?

- Që nënkupton?

- Kam qenë i pavarur nga vetja, por jo nga Fiona.

- E prisja këtë përgjigje! - ia ktheu krahët ajo dhe hyri në banjë para tij. Ai e ndoqi i prekur në sedrën e një burri edhe pse nuk dyshonte aspak në dashurinë dhe singëritetin e saj, por kuptoi se, më pas do t'i duhej të tregohej më i kujdesshëm me ndjeshmërinë e së dashurës. Karakteri i saj, e befasonte në një mënyrë të veçantë dhe po i bëhej e pamundur, më shumë se ndaj kujdesit për Fionën, arratisja prej përgjegjësisë vetjake. Kishte ndodhur një ndryshim.

Do të mjaftonin vetëm disa orë për të parë dhe njohur çdo pjesë të asaj mrekullie, për të cilën Fiona do të shprehej, se ai vend ishte një pasqyrim në miniaturë i bukurisë së jetës dhe madhështisë së natyrës. Kishte mundur t'u mbijetonte shekujve dhe vazhdonte të mbretëronte krejtësisht i pavarur nga gjuha e kohës. Nderur mbi humnerën oqeanike, kaltërsia e qiellit puthte këndshëm atë gjelbërim mahnitës, i cili të imponohej pavarësisht vëmendjes, ndërsa ai komunikim paqësor dhe aq sundues, përcillte pa fjalë, ndjesinë e përjetësisë.

Fiona lëvizte e lehtë dhe, çuditërisht, edhe shumë më e qetë, ndërsa Xhejmsi vazhdonte të mbështeste entuziast, shprehjet apo reagimet e befta të saj, me një fytyrë të gëzuar. Zbuluan se ishulli kishte vetëm disa banesa të vogla e të izoluara turistësh, krahas të tjerave, të cilat mundësonin funksionet e shërbimit dhe njëkohësisht edhe strehimin

për personelin, apo banorët e tij. Bimësia e dendur dhe e shëndetshme, fshihte çdonjëren prej ngrehinave, duke krijuar një intimitet të natyrshëm dhe sigurisht edhe të pranueshëm për vizitorët. Fionës i duhej kjo, sepse ishte qëllimi që e kishte shtyrë ta zgjidhte pikërisht atë ishull.

Dhe, ndërsa lëviznin duke parë e prekur gjithçka, mes të tjerash, njohën atje edhe dy fytyra shumë simpatike, ishin dy vajza afërsisht në moshën e Fionës. Kelli, kështu e quanin njëren, ishte një krijesë e përsosur fizike. Mësuan prej tyre, se do të pushonin atje vetëm dhjetë ditë. Gjatë prezantimit ato u befasuan disi nga mosha e Xhejmsit dhe u larguan duke i pëshpëritur njëra-tjetrës, por Fiona nuk mendoi gjatë për këtë. Xhejmsi ishte dashuria e parë e saj. Fionën çuditërisht e tërhiqnin moshat më të rritura, ndoshta kishin ndikuar Klara dhe Sofia, ose thjesht mbetet përcaktuese përmbajtja e saj. Bashkëmoshatarët i konsideronte gjithmonë më të vegjël, lodhej duke paragjykuar sjelljen dhe veprimet e tyre, të cilat edhe pse mbanin vulën e psikologjisë dhe kërkesave normale të moshës, nuk e ndihmonin aspak për të gjetur argumentin, që mund ta shtynte drejt tyre.

Ndodhi që, pas takimit të parë me Xhejmsin, ajo kishte provuar t'i shmangej, pa asnjë arsye të fortë, me premtimin e heshtur se nuk do ta takonte herë tjetër, por ishte ajo që e kërkoi dhe vazhdoi ta takonte shpesh e më shpesh, deri te momenti kur pasigurinë fillestare do ta konsideronte një marrëzi.

E tërhoqën qëndrimi dhe pikëpamjet e tij, mënyra e arsye-timit dhe, pse jo, mund të thoshte se edhe stili i veshjes.

Ajo e vlerësonte pjesërisht edhe këtë detaj, si shprehje të karakterit dhe si reflektim të një motivi të rëndësishëm brenda nesh, atij të respektimit të vetes dhe tjetrit, në sfondin e civilizimit dhe evoluimit të marrëdhënieve njerëzore. Mbetej e pashmangshme kjo, në botën ku jetonin, ku merrnin dhe ku jepnin, asaj i duhej të përshtatej gjithsesi, por me një përparësi, ajo dinte të ruante masën e gjërave. S'mund të thoshte se Xhejmsi kishte fytyrë të bukur, por në sytë e saj e bënte aq tërheqës dhe shumë interesat personaliteti. Ishte një financier me aftësi të spikatura dhe drejtor i një korporate të fuqishme marketingu, me akses ndërkombëtar. Banonte në një apartament shumë komod në qendër dhe frekuentonte rregullisht çdo gjë që i shërbente një jetese të shëndetshme, me energji dhe emocione pozitive. Ajo i mësoi këto detaje, vetëm pasi ishin njohur, asnjëherë nuk prirëj drejt gjërave materiale. Fiona nuk e tërhiqte as bota e financës, ajo vetë do të diplomohej në arkeologji, por jo gjithmonë mund ta gjejmë shkakun, apo thjesht edhe arsyen se përse na ndodh kjo apo ajo.

E edukuar të ndiqte ndjenjën dhe të respektonte veten, Fiona do të gjendej e papërgatitur dhe pothuajse bosh, si një notar që kupton i trembur se po e braktisin energjitë shumë larg tokës, vetëm para elementit Gebi. Ajo ishte një vajzë shumë e bukur, me sjellje tepër provokuese në ambientet argëtuese dhe me adhurues të përherëshëm. “S’po të kuptoj Xhejms, - i kishte thënë gati e fyer, - kjo është një eksperiencë e panjohur për mua dhe, sigurisht, edhe e papranueshme”, - ishte shprehur më pas Fiona, në mungesë të tjetrës,

ndërsa ai mundohej të shpjegohej rreth atij kompleksi tepër sensual, i cili sipas konceptit të tij, imponohej dhe zhvillohej, në varësi të nevojës fiziologjike, krejtësisht i pavarur nga materiali shpirtëror. Gjithçka funksiononte si një tërësi, ku organizimi i shprehive brenda saj, motivohej zakonisht nga influenca instinktive të momentit, kushtëzuar përkohësisht edhe nga ngacmime spontane të mjedisit. Mbetej, sipas tij, vetëm një reaksion sipërfaqësor, kalimtar dhe i parëndësishëm, i cili do të shpërbëhej më pas pa lënë gjurmë, për t'u rishfaqur ndoshta, ose jo, nën një tjetër formë, apo influencë të rastësishme dhe kjo gjendje, do të ripërsëritej, si në një serial.

Perceptimi i tij edhe pse i sinqertë, e ngarkoi edhe më pasigurinë e Fionës, por ajo s'mundi të largohej. Provoi të absorbonte atë shije të re midis tyre edhe pse në heshtje, ajo e konsideroi një mundësi të dështuar besimin ndaj tij. Atë frymëmarrje të re, vazhdoi ta mbante pezull, padrejtësisht dhe aq varfërisht, vetëm sinqeriteti i Xhejmsit, pavarësisht reflektimit zhgënjyes dhe të paturpshëm për opinionin e saj. Nuk foli me Elin, sepse e njëjtte reagimin dhe nuk donte të linte gjurmë mbi sfondin e pastër të besimit prindëror. I duhej kjo për të fituar edhe pak kohë, ndërsa luftonte me ndjenjën. U shpreh para tij se ndoshta do ta kishte të pamundur ta lejonte, se s'ishte përballur asnjëherë me një akt aq ekstrem dhe se nuk i ishte dhënë mundësia të provonte rezistencën ndaj asaj gjendjeje. A ishte e mjaftueshme? Disa simpati të shkurtra pas atij incidenti, do të kalonin pa u ndier mes tyre, por rasti i Gebit penetroi krejtësisht

i papërballueshëm prej saj. Filloi të pyeste veten se përse vazhonte të kërkonte ende te Xhejmsi, por njëkohësisht e pamundur edhe të tërhiqej. Dukej e vështirë të paragjykonte veten më shumë se tjetrin, ndërsa ai orvatej të argumentonte se marrëdhëniet, kalimtare sipas tij, në çdo rast, s'ishin tjetër veçse pjellë e spontanitetit dhe pa emocion, ndodhnin zakonisht kur ai ndihej shumë i lodhur dhe pak i dehur dhe se në fund gjithçka humbiste pa gjurmë.

Edhe pse konflikti mbetej pezull mbi kokat e tyre, kur si viktimë e dashurisë së vet, Fionës do t'i duhej të përulej para asaj shfaqjeje anormale për të, duke mohuar padashur se shpesh rastësia dhe e panjohura, mbeten aq të qenësishme dhe përcaktuese brenda materies sonë, sa ndodh edhe t'i paraprijnë asaj, përsëri s'mundi të largohej. Ajo u ngrit e ftohtë dhe mospërfillëse ndaj atij realiteti, i cili ditë pas dite, vazhdon të rigjenerojë humbjen në themelet e reja të ekzistencës sonë dhe ndodh shpesh edhe ta përcaktojë atë deri në fund, fatkeqësisht edhe duke qeshur me verbërinë e viktimave të paorientuara dhe çmendurisht të pazëshme.

Frika se ndoshta po gabonte duke u ngritur padrejtësisht mbi vetveten, nuk e pengoi për të pranuar se i duhej më tepër kohë për t'i pohuar vetes se kishte bërë gjithçka mund të bënte në emër të dashurisë dhe respektit për veten, të cilat ndoshta aksidentalisht po talleshin me Fionën. Atëherë ajo kërkoi këmbëngulëse të mbetej vetëm, me nevojën e një komunikimi më intim, larg zhurmës dhe jehonës së qytetit, të cilën edhe pse e ndiqte dhe dëshironte, nuk mund ta pranonte asnjëherë jashtë tempullit shpirtëror. Dyshimi se

ndoshta po humbiste duke sakrifikuar kohën dhe duke vrarë parimet, nuk po i ndahej dhe, në fund, për të kuptuar më mirë dhe për të bërë atë që do ta ndihmonte ndoshta të mos pendohej nesër, vendosi të dilte përkohësisht jashtë rrjedhës dhe kontakteve të njohura.

Xhejmsi zakonisht punonte shumë dhe shprehej vazhdimisht se i duhej shpejt një pushim i gjatë ndaj nuk e kundërshtoi kërkesën spontane të saj, i kërkoi vetëm disa ditë të domosdoshme për t'u shkëputur nga detyrimet e punës dhe entuziast pranoi ta ndiqte. Në fund, pas një udhëtimi interesant, ata mbetën vetëm, brenda atij rrezatimi të magjishëm, pikërisht sipas parashikimit të Fionës. Eli dhe Maksi e kishin respektuar zgjedhjen e saj, shoqëruar edhe me këshillat e përhershme dhe aq të njohura për Fionën, diçka rreth bukurisë dhe personalitetit të një vajze të denjë. Ajo, gjithashtu, ndihej e sigurt dhe e bindur se nuk do t'i zhgënjente.

Edhe pse fytyrat e reja rrotull tyre nuk ngjanin aspak të rëndomta dhe indiferente, fillimisht Xhejmsi nuk kishte shprehur asnjë konsideratë, nuk e bëri edhe kur Fiona ia kërkoi këtë dhe kjo e ngatërroi përsëri veprimin e *Fionës* dyshuese.

- Sot dukesh e mrekullueshme! - i tha ai, pikërisht kur ajo po priste të dëgjonte një tjetër shprehje, ndryshe nga e njohura midis tyre. - Mendoj të shkojmë menjëherë në plazh, e dashur, më duhet të ndërroj lëkurën e vjetër.

- Sa keq që ky *purifikim* sipërfaqësor nuk përcakton asnjëherë mënyrën si duhet të sillemi dhe mbetet aq larg

asaj që mendojmë se jemi, apo jo, Xhejms? - kërkoi sërish Fiona.

- Sigurisht, e dashur, unë nuk mund t'i shmangem varësisë me emrin Fiona, por, a mund të më japësh pak liri, të lutem, a mund të jem i pavarur nga argumenti, të paktën në këtë parajsë?! Më ndihmo të pushoj, e dashur! A mund të bëjmë vetëm disa ditë pa moralin dhe predikimet e tua?

- E drejtë, jam vërtet e çmendur Xhejms, pothuajse harrova se përse ndodhemi këtu, më fal! - u tërhoq ajo, e kujdesshme të mos shkaktonte mjegull mes tyre. Më mirë të priste, me siguri ai do ta ndihmonte të njihte të nesërmen dhe, për herë të parë, i dha të drejtë. Duhej ta linte veten të lirë të pushonte.

Dy vajzat simpatike befas u shfaqën përsëri pranë tyre dhe ngritën menjëherë dorën për t'i përshëndetur. Fiona bëri po atë, por nuk i thirri. Ndërkohë Xhejmsi shtroi peshqirët mbi dy karriget e plazhit dhe u shtri me një kënaqësi të dukshme në njërin prej tyre. Po të përjashtoje të saponjohurat, si edhe portretin e një çifti të panjohur pak më tej, ata të dy gjendeshin krejtësisht vetëm, përballë harmonisë magjepsëse të një perëndimi oqeanik. Ajo u shtri pa fjalë pranë tij dhe, shumë shpejt, humbi nëpër udhëkryqet e pavetëdijes. Fytyra e Gebit, vazhdonte ta ndiqte edhe nëpër ëndrra. A do të mundej të shpëtonte prej saj dhe a do ta ndihmonte ai vend?

*Para saj zhvendosej silueta e një gruaje të panjohur. Më pas ajo hyri midis tyre edhe pse nuk donin, me sy të ftohtë dhe një buzëqeshje pa ngjyrë, që edhe pse mundoheshin ta*

*kapnin për të mos humbur në humnerën e ngrirë të shikimit të saj, nuk mundën. Rrëshqiste si hije dhe në çdo kontakt përcillte te Fiona energji negative, e cila shumë shpejt do të nderej mbi ngrohtësinë e ndjenjës tashmë të gjymtuar dhe do të mbyllte çdo shteg rigjenerimi. Ajo ishte bërë pjesë e jetës së tyre dhe e së nesërme, po merrte trajtë përherë e më të qartë dhe atje, Fiona njohu Gebin. Ai emër po hynte i egër në çdo qelizë të lëkurës tepër të brishtë, mbi trupin e zhveshur të Fionës, ndërsa kjo filloi ta respektonte padashur atë kontakt dhe çuditërisht edhe të përulej para tjetrës. Çfarë po ndodhte mes tyre, përse duhej ta bënte, apo se në të kundërt konflikti do të godiste mbi vetë Fionën? Ndihej e lodhur, ndihej tmerrësisht e lodhur, ndaj nxitoi të tërhiqej e bindur se portreti para saj ishte një krijesë hipokrite dhe kundërvënëse.*

*A e donte vërtet Xhejmsin dhe a ishte e pastër ajo figurë e errët, të paktën në dashurinë e saj, por jo, a ishte vërtet ashtu, të paktën vetëm me Xhejmsin... Po, ku ishte zhdukur Xhejmsi... “Xhejms, duhet të flasim, Xhejms...” Fiona, jam këtu Fiona, Fiona...” - dëgjoi nëpër ëndërr zërin e tij...*

- Hej, Fiona, Fiona! - ishte Xhejmsi që po mundohej ta zgjonte. Ajo hapi sytë dhe u ngrit menjëherë, pa kuptuar ende ku ndodhej.

- O Zot, bëre mirë që më zgjove! Oh, çfarë ëndrre!

- Mos duhet të jetoj i vetëm në shoqërinë e palmave, e dashur?

- Pashë një ëndërr të keqe Xhejms, të tmerrshme... Sa mirë që më zgjove!

- Isha unë brenda saj? - qeshi ai, pa e marrë seriozisht reagimin e së dashurës.

- O Zot, çfarë ëndrre, gati po më zihej fryma, o Zot! - dhe Fiona vështroi përreth, me një fytyrë të hutuar. Ndihej ende e pushtuar nga efekti i atij vegimi. Ai nuk priti të dëgjonte më tej, por e tërhoqi drejt ujit, ndërsa ajo e ndoqi si somnambul. Mendoi se ndoshta do t'i duhej më tepër kohë të harronte dhe të sfidonte fantazmat mbi kokën e saj, por gjithsesi, nevoja për t'u shprehur dhe folur me dikë, po bëhej e papërballueshme, ndërsa Xhejmsi pushonte i qetë pranë saj.

\* \* \*

Në banesën e tyre, shërbente çdo ditë Llina, një grua me lëkurë të zeshkët, forma të rrumbullakosura hijshëm, me uniformën përherë të pastër e plot ngjyra dhe me një sjellje çuditërisht fisnike. Fionën e tërhoqi menjëherë fytyra e këndshme e saj, me tipare të spikatura aziatike, me hijen e banorëve të kahershëm të atij ishulli, por e preku gjithashtu edhe preokupimi shembullor i saj gjatë orëve të shërbimit. Ndodhte shpesh t'i kërkonin peshqirë ekstra, ushqime të zgjedhura apo një pije të veçantë dhe ajo do t'iu përgjigjej në çdo rast dhe pa hezitimin më të vogël me buzëqeshjen e përhershme. Kështu, ditë pas dite, ajo simpati e dyanshme, po merrte trajtat e një miqësie. Llina prirej të gjente kudo diçka të mirë, të bënte e zellshme atë që mundej dhe ishte lehtë të kuptoje se ajo e donte jetën. Ajo grua ngacmoi

kureshtjen e Fionës, së cilës i bëri përshtypje të veçantë optimizmi i saj. Paraqitej çdo ditë e pastër dhe e veshur me kujdesin e një gruaje të bukur. Vuri re se Xhejmsi filloi të largohej gjatë kohës kur ajo merrej me Llinën, iu thoshte se po shkonte të luante dhe argëtohej te fusha e shahut, ku sipas tij zhvendosja e gurëve të mëdhenj, e ndihmonte të ruante linjën dhe të forconte përqendrimin, por Fiona e kuptoi shpejt arsyen. Në mungesë të tij, ato mund të flisnin lirshëm për gjithçka. Fionës i pëlqeu t'i tregonte edhe për origjinën dhe vendin ku ishte lindur dhe kishte hedhur hapat e parë, për traditën e familjes shqiptare, kujtimet e fëmijërisë dhe dëshirën për t'u kthyer shpesh atje. Llina e dëgjonte pa e ndërprerë dhe foli vetëm kur Fiona ndaloi.

- Sa kohë pa u kthyer atje?

- Gati tre vjet, por po e kujtoj më shpesh pas njohjes me Xhejmsin. Është një ndjesi e çuditshme kjo, nuk e kuptoj!

- A ndihesh mirë pranë tij?

- Sa dua të ndodhë kështu! - dhe Fiona nxitoi t'i tregonte për ëndrrën e frikshme, me personazh Gebin, për pasigurinë ndaj sjelljes së tij, arsyen e largimit me pushime dhe qëllimin e fshehur të saj.

- Më ka thënë se s'ka pasur asnjë lidhje të gjatë dhe serioze, se unë jam një vajzë e veçantë si asnjëra prej tyre dhe se, për sa kohë do të ecim të dy, gjithçka duhet të shkojë mirë. Duhet të besojmë, shprehet vazhdimisht, disa gjëra duhet t'i besosh, sepse të ndihmojnë të njohësh më mirë.

- Mendoj se kjo është e pranueshme, kur ato që sheh nuk lënë shteg për asnjë keqkuptim, Fiona, por te Xhejmsi!

Më duket se është pikërisht ai që provokon një qëndrim dyshues. Unë mendoj si ti, por nuk do të veproja kështu!

- Pse, ku kam gabuar, Llina?

- Dua të them se paqja në këtë qoshe të këndshme do të jetë e përkohshme. Ju do të ktheheni sërish atje dhe gjithçka do të rifillojë me po ato figura ngacmuese dhe prirjen e Xhejmsit ndaj tyre, por vetëm atje ti mund të njohësh kush është Xhejmsi i vërtetë, duke e lënë të lirë edhe në shoqërinë e Gebit, edhe të një tjetre po ta kërkojë atë, krijoi mundësinë të zgjedhë midis jush dhe, të siguroj Fiona, do të vijë krejt natyrshëm momenti kur ai të kthehet përfundimisht te dashuria e tij. S'të mbetet rrugë tjetër! Vetëm në rast se do të vendosësh t'i kthesh krahët! Por duhet të jetë zgjedhja jote.

- Edhe sa Gebi duhet të përballoj Llina, a kupton çdo të thotë kjo? Mendoj se është në një moshë kur di çfarë duhet të zgjedhë! Është një lojë kaq qesharake kjo, ndërsa unë një vajzë naive! Sa e vështirë të ngrihesh mbi veten!

- Është e vështirë engjëlli im, por jo e pamundur! Ndoth që njeriu të ngrihet mbi veten në dy raste, kur urren shumë dhe kur dashuron shumë. E shoh, ti nuk do ta humbasësh dashurinë, por e pamundur të jetoni të izoluar, vetëm për njëri-tjetrin! Po kërkon një Xhejms të pastër, kështu si ti, dhe ky ishull është një perlë për të pushuar, por jo për të burgosur ndjenjën dhe shpirtin. Po kërkon prej tij të mohojë identitetin për të ruajtur të paprekur dashurinë tënde dhe këtë shpreson ta gjesh këtu, në vetmi?! E gabuar!

- Mos duhet të lejoj të më shkelin? Sikur Gebi nuk ekziston?

- Më dëgjo, Fiona! Nuk duhet t'i kundërvihesh as Gebit, as tjetrës që mund të vijë pas saj, duhet ta ndjekësh rrugën me Xhejmsin dhe intuitën tënde, por mbi të gjitha duhet të respektosh veten. Mendoj se duhet të presësh për këtë, derisa njohja të prekë pragun e pendesës, mos gabo të shtyesh më tej, sepse pas kësaj kjo gjendje do të marrë shpejt përmasat e një faji, i cili do të të ndjekë dhe terrorizojë deri në shkatërrim të panevojshëm shpirtëror. Në rast se ai do të kthehet para se të lindë te ti ndjenja e pendesës, marrëdhënia juaj me siguri do të shohë dritën e kurorëzimit, në të kundërt sakrifikimi yt do të jetë një hiç, pa vlerë, sepse Xhejms nuk mund të dojë ndonjëherë, të jesh e sigurt për këtë dhe fatkeqësisht, ai do të arrijë të vjedhë edhe një pjesë të bukur të rinisë sate. Më dëgjon Fiona, këtë duhet të bësh!

- Mbetet i vetmi shteg? Dua të them, sakrifikimi im për...

- Në rastin tuaj, mendoj se po! Mos u mundot t'i imponohesh me vështrime, apo fjalë provokuese, por lëre të zgjedhë e të vlerësojë ai i pari dhe kjo, mendoj se është normale, nuk keni kohë bashkë, apo jam gabim? Por edhe koha ndonjëherë...

- Që do të thotë, diçka më konkrete Llina, ti je fantastike! Nuk prisja të dëgjoja kaq shumë nga ti!

Dhe ajo grua e bukur, me një botë aq interesante, vazhdoi të shpaloste para Fionës përvojën e jetës dhe prirjen pozitive. Ishte aq e këndshme dhe e brishtë vajza e pasigurt para saj! E, më pas, Fiona do t'i tregonte se natyra e vendit ku kishte lindur, ishte po aq e bukur sa Kalifornia Jugore, se atje kishte mjaftueshëm vlera që duhej të mos humbnin,

se ajo mbështeste për këtë opinionin e prindërve, se do t'i pëlqente të thërriste, të kërkonte atje, të trokiste në dyert e mbyllura të së djeshmes edhe pse e vjetër, e harruar dhe me mjaft gjurmë të errëta ndër vite, por kishte edhe ajo tinguj të bukur, unikë dhe të pazëvendësueshëm, e se pavarësisht të gjithave, mbi ta mund të mbështetej plotësisht e sigurt e nesërmja e vendlindjes së saj. Llina u largua e mallëngjyer, për t'u rikthyer të nesërmen me një pamje po aq të freskët dhe ngjyra të reja në portretin e një gruaje të bukur.

Por Xhejmsi vazhdonte të mos kuptonte asgjë nga sjellja e çuditshme e Fionës. Ndihej sikur lidhja e tyre po humbiste ekuilibrin e zakonshëm dhe mbi po atë pasiguri të ndërsjellë, ku ai s'mund të kontrollonte as veten dhe as Fionën tekanjoze, vajza para tij dukej ndryshe. Mos ndoshta e lodhur nga ajo lojë e gjatë provokuese, kishte zgjedhur heshtjen? Por edhe kjo nuk ishte e sigurt, sepse ai sillej aq i dashur dhe i përkushtuar ndaj saj, aq korrekt, të paktën brenda jetës së atij ishulli të mahnitshëm! Apo nuk po mjaftonte kjo, për të kuptuar sa shumë e donte?

Para një viti, e kishte tërhequr aq spontanisht portreti i saj. Në fillim ai mendoi ta trajtonte si një element fizik, që do të dilte shpejt nga jeta e tij dhe kjo i ndodhte shpesh. Nevoja fizike dhe mënyra si paraqitej gjinia tjetër para tij, do t'i impononte përherë një sjellje të pandryshuar dhe gjente aq shumë rrotull vetes, por në rastin e Fionës asgjë nuk shkoj sipas parashikimit, ndoshta sepse sinjalet nuk kishin qenë ato të zakonshmet. Shpejt do të zbulonte atje një qëndrim të pazakontë, ndryshe nga zërat brenda rrethit

shoqëror ku ishte formuar dhe shijes me të cilën ishte rritur ai. Vlerësoi te personi përballë një sens të natyrshëm dhe aq të jashtëzakonshëm kontrolli. Ishte studente dhe fliste një anglishte të përsosur. Ai u befasua gjithashtu kur ajo i tregoi se vinte nga një vend i vogël europian, por e kuptoi përse sjellja e saj kryqëzonte tendencën e përgjithshme dhe ashtu, me një kureshtje të pazakontë, krejt papritur ai fakt i imponoi një qëndrim më të kujdesshëm. Do ta shprehte edhe para Fionës, duke i thënë se ishte ndryshe, ndërsa ajo kishte qeshur fort, kur më pas ai guxoi ta krahasonte me një gur të çmuar, me një diamant të vogël, por me vlerë aq të madhe. Kishte pritur me frikën se ajo do të largohej, por mrekullisht nuk ndodhi dhe ai e ndoqi, ashtu si nuk kishte bërë asnjëherë më parë. Ajo vajzë ishte shumë e zgjuar dhe e edukuar për ta trajtuar në mënyrën e tij, kurse ai një fytyrë aspak frymëzuese në moshën e pjekurisë. Çfarë kërkonte Fiona tek ai, përse vazhdonte ta thërriste?! Vështirë të besonte se mund të ishte dashuri, aq e pamundur i ishte dukur kjo mbështetur në hapat e njohur, ndaj për të kthjelluar paqartësinë e rastit, kishte zgjedhur Gebin. Para lidhjes me Fionën, njihte shumë prej tyre, dhe ato mund të luanin çdo rol, me partner të rregullt ose jo. E ndërtoi skenarin për të vënë në provë Fionën. Gebi luajti mirë deri në fund. Fiona shfaqti shenjat e para të xhelozisë dhe ky fakt i pëlqeu. Ai u shmang në momentin e fundit, pa i treguar qëllimin e asaj marrëzie që me sa dukej, po i kushtonte. E kuptoi edhe arsyeën e vendimit spontan për të shkuar me pushime dhe nuk e kundërshtoi, por Fiona vazhdonte të endej diku jashtë

tij dhe kjo po bëhej e rrezikshme. E pamundur të ndiqte hapat e rinj të Fionës.

Jeta kishte qenë bujare me Xhejmsin dhe krahët e fatit, mrekullisht asnjëherë nuk e kishin harruar, apo braktisur. Pas një përvoje disavjeçare dhe suksesit në sajë të aftësive dhe intuitës, arriti të ngrihej në pozicionin e drejtuesit kryesor të një korporate të fuqishme investimesh, brenda dhe jashtë kontinentit amerikan. Të ardhurat tepër joshëse dhe talenti profesional, i hapën dyert e sferës elitare të shoqërisë. Banonte në një apartament shumë komod në qendër të qytetit dhe frekuentonte ambientet më luksoze. Kishte përshtypjen se i duheshin edhe disa vite për të kërkuar një lidhje serioze, sepse ndjente ta tërhiqte ende jehona e një jete të pavarur. Me Fionën e kishte lidhur rastësisht aktiviteti i zakonshëm jashtë punës dhe, pas kësaj, ai kërkoi si pa kuptuar të ndryshonte stilin e jetesës. Çfarë kishte bërë, ku kishte qenë dhe përse, kush ishte ajo vajzë interesante dhe ç'kërkonte prej tij? Iu duk vetja i marrë kur filloi të shpresonte, por ndodhi që fatmirësisht mbeti atje, ndërsa vajza e ëndrrave, me emrin Fiona, do të drejtonte më pas jetën e tij, si një sirenë.

Vuri re se ajo po shfletonte një libër, pa u ndalur gjatë në asnjë pjesë të tij. I bindur se diçka ishte ndryshe dhe i vendosur t'i shmangej përfundimisht atij konflikti torturues, i tha vetes se duhej të çlirohej sa më shpejt prej atij dyshimi.

- A mund të shëtisim në plazh, Fiona?

- A nuk luajte shah, mjaft për sot!

- Po, ti, a u kënaqe me Llinën?

- Është grua e mirë dhe interesante! Më befasoi me horizontin që ka, nuk prisja ta prekja atë artikulumin.

- Nuk kam asnjë paragjykim, vetëm se kërkoj të dalim tani, menjëherë, më duhet kjo! Ose thjesht shëtisim këtu pranë, zgjidhe ti. Mbetem gjithmonë i hapur.

- Vetëm unë edhe ti?

- Po, kush tjetër, apo me Llinën? - qeshi ai pa kuptuar nëntekstin e saj, po e nervozonte aq keq ai qëndrim dyshues.

- A s'është shumë e bukur Kelli, sepse mungon Gebi këtu! Mund t'i ftojme ato vajza, ndoshta edhe unë... Provojmë një herë!

- Më duket se s'kam shprehur asgjë që të ngacmojë imagjinatën tënde, por mendoj se po harrojmë cilët jemi, përse ndodhemi këtu! Ç'mund të thuash për këtë?!

- Po habitem si nuk po e ndien mungesën e qytetit!

- Po aludon për Gebin, vërtet! - nuk u përmbajt ai.

- Një figurë e pakrahasueshme, megjithëse tepër e lehtë, por ti e pëlqen, apo jo, Xhejms? - këmbënguli të shkante më tej ajo, nën efektin e dyshimeve dhe pasigurisë që po e shoqëronte prej fillimit të njohjes me vajzën e lojës së tij.

- Përse erdhëm këtu dhe a je e sinqertë me mua? Jam shumë më i madh se ti dhe duhet të më respektosh për këtë. Mjaft, u lodha me këtë sjellje!

- Më duket se po bëj atë që sapo dëgjova, i dashur, po respektoj pikërisht dëshirën tënde! - vazhdoi të ngacmonte, Fiona.

- Kujtoj të kem thënë se unë s'mund të ngrihem kurrë mbi dashurinë tënde dhe jam i sigurt për këtë! Ti e di, Gebi